



ORGANIZATA PËR DEMOKRACI, ANTI-KORRUPSION  
DHE DINJITET – ÇOHU!

**NJË VIT ME QEVERINË THAÇI**  
**MONOPOLIZIMI I SHTETIT DHE**  
**INSTITUCIONALIZIMI I KORRUPSIONIT**

RAPORTI # 11

JANAR 2009

Rruga “Ahmet Krasniqi” #5, Arbëri, Prishtinë  
[organizatacohu@yahoo.com](mailto:organizatacohu@yahoo.com)  
[www.cohu.org](http://www.cohu.org)

## Hyrje

Ky raport i Organizatës ÇOHU! është raport monitorues mbi njëvjetorin e Qeverisë Thaçi dhe mbulon qeverisjen nga janari 2008 kur është formuar kjo qeveri deri në janar të këtij viti. Në këtë raport sikur edhe në monitorimet e kaluara preken fushat më të rëndësishme të qeverisjes në Kosovë si dhe prioritetet e qytetarëve të Kosovës bazuar në hulumtime të ndryshme të opinionit.

Raporti fillon me analizimin e logjikës që dominon në Qeverinë Thaçi, në kontekst të së cilës logjikë zhvillohen politikat dhe objektivat e kësaj qeverie. Shëndetësia dhe arsimi, kompanitë publike, emërimet politike dhe kontratat e dyshimta me kompani private, mungesa e llogaridhënies, rreziku nga autoritarizmi si pasojë e nënshtrimit të Kuvendit të Kosovës, neutralizimit të opozitës, kapjes së agjensioneve të pavarura, politizimit të policisë dhe të gjykatave, si dhe kontrollit ndaj mediave nga ekzekutivi, të gjitha këto fusha janë mbuluar dhe vënë në kontekst politik të logjikës qeverisëse aktuale. Është kjo logjika e përqendrimit në imazh publik dhe konsolidimit të kontrollit të PDK-së në fushat vitale publike.

Tendenca të rrezikshme gjatë këtij viti janë sidomos përdorimi i policisë për disa arrestime spektakolare. Në disa raste duket sikur policia është përdorur vetëm si konsekuencë e akuzave publike të kryeministrit Thaçi drejtuar ndonjë institucioni siç ishin arrestimet në Aeroport apo janë përdorur thjesht dhe vetëm si një mënyrë për të zhvendosur vëmendjen e opinionit publik nga ndonjë dështim i qeverisë siç ishte rasti i arrestimeve në dogana dhe në veri të Mitrovicës.

Raporti i përmend edhe disa nga sukseset e Qeverisë Thaçi të realizuara gjatë këtij viti të qeverisjes së saj. Ajo çfarë ka rënë në sy qysh nga ardhja në pushtet e kësaj qeverie është shtrimi i më shumë rrugëve dhe ndërtimi i më shumë shkollave, objektiva këto bazike por në të cilat qeveritë e kaluara kanë dështuar. Poashtu qeveria ua ka rritur rrogat një pjese të shërbyesve civilë si mjekëve, arsimtarëve dhe mësuesve, mirëpo ka dështuar në respektimin e marrëveshjes me sindikatën e policisë për rritjen e rrogave Policisë së Kosovës. Një sukses fillestar që mbetet të shihet sesi do të vazhdojë muajve në vijim është shkyçja e borxhlinjve të KEK-ut e sidomos bizneseve të cilat janë ndër borxhlinjtë më të mëdhenj të kësaj korporate.

Këto suksese të lartpërmendura, megjithatë, mbipeshohen nga dështimet e kësaj qeverie në shëndetësi, në kompanitë publike, në zbutjen e varfërisë dhe papunësisë, nga tendencat sunduese autoritare, si dhe nga politikat shkurtpamëse që favorizojnë interesin e ngushtë të partisë më të madhe në pushtet, PDK-së. Shtrimi i më shumë rrugëve dhe shkollave nuk është domosdoshmërisht pozitive nëse ato nuk bëhen në kuadër të një plani të zhvillimit të përgjithshëm afatgjatë; rritja e rrogave shërbyesve civilë nuk duket të jetë bërë duke u bazuar në një buxhet dhe plan makroekonomik që siguron zhvillim të qëndrueshëm dhe rritje të vazhdueshme rrogash. Në këtë kontekst edhe privatizimi i PTK-së dhe kompanive tjera publike merr kuptim si sigurim i mjeteve për të blerë paqën sociale.

**Metodologjia**

Si edhe në raportet e mëparshme të Organizatës ÇOHU!, edhe në këtë, metodologjia e përdorur është gjithëpërfshirëse duke shfrytëzuar burime të shumta për të mbuluar sa më mirë fushat e prekura në këtë raport. Monitorimi i mediave gjatë kësaj periudhe kohore njëvjeçare dhe intervistat që anëtarët e ÇOHU!-t kanë zhvilluar me shërbyes civilë, zyrtarë të qeverisë, ekspertë të fushave të caktuara, etj, ka shërbyer për të identifikuar logjikën qeverisëse të Qeverisë Thaçi. Raportet e instituteve dhe institucioneve vendore dhe ndërkombëtare janë konsultuar dhe shfrytëzuar për të plotësuar raportin me të dhëna të reja apo për të konfirmuar gjetjet fillestare.

## LOGJIK A QEVERISËS E

### **Përqendrimi në imazh publik**

Prej ardhjes në pushtet të Qeverisë Thaçi në janar të vitit 2008 është vërejtur se dy prioritetet e kësaj qeverie nuk kanë qenë papunësia dhe varfëria apo luftimi i korrupsionit<sup>1</sup>, siç kishte deklaruar shpesh kryeministri Thaçi me pompozitet. Shtrimi i rrugëve dhe ndërtimi i sa më shumë shkollave gjithandej Kosovës kanë qenë prioritetet e kësaj qeverie. Krijimi i infrastrukturës fizike është një prej parakushteve për luftimin e varfërisë dhe uljen e papunësisë, mirëpo kjo nuk është përcjellur me një program ekonomik që do t'i kishte këto dy objektiva si prioritetet e tij. Në fakt ëshë e panjohur për qytetarin e Kosovës se sipas cilave kritere caktohen prioritetet nga qeveria e Kosovës. Pse infrastruktura rrugore dhe arsimore merr përparësi kundruall varfërisë dhe papunësisë, luftimit të korrupsionit e reformimit të sektorit të shëndetësisë? A ka qeveria e Kosovës ndonjë plan gjithëpërfshirës brenda të cilit integrohen interesat dhe nevojat prioritare të qytetarëve të Kosovës, brenda të cilit plan edhe ndërtimi i më shumë rrugëve dhe shkollave do të ishin prioritetet që integrohen si pjesë përbërëse të një plani të përgjithshëm për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm afatgjatë?

Kjo qeveri nuk ka program ekonomik e as plan qeverisës. Mirëpo kjo qeveri e ka të sofistikuar strategjinë për kontrollimin e informacionit publik. Këtu po ndodhë një proces simultan në dy linja: në njërin anë qeveria po kujdeset që imazhi i saj të mbetet i paprekur, në anën tjetër po ndodhin shkelje të shumta në kompanitë publike, privatizim dhe qeverisje. Përqendrimi në imazh publik bëhet me qëllim të fshehjes së këtyre shkeljeve në kompanitë publike, në marrëveshjen e dëmshme të PTK-së me Dardafonin, në marrëveshjen e KOSTT-it me Komtel-in, në emërimet politike në bordet e kompanive publike, në privatizimin e dështuar dhe tendencën autoritariane për të kontrolluar institucionet e pavarura. Përveç kryeministrit Thaçi, edhe tre anëtarë të kësaj qeverie kanë qenë të llastuarit e mediave: ministrat Limaj, Hoxhaj dhe Pajaziti. Nëse ka pasur një kritikë drejtuar qeverisë apo kryeministrit në veçanti, të nesërmen ai është paraqitur në mediat nën ndikimin e tij për të “restauruar” imazhin e tij dhe të qeverisë.

Gjithashtu, ka edhe një tendencë të kryeministrit Thaçi për të fabrikuar historinë dhe monopolizuar të vërtetën. Në raportin e qeverisë për njëvjetorin e punës së saj kryeministri ia atribuoi vetit meritat për pavarësinë e Kosovës duke e njehur shpalljen e saj si meritë të qeverisë së drejtuar nga ai. Në mediat e kontrolluara nga kryeministri po inicohen debate të paqena me dy qëllime: nën një, po tentohet të zhvendoset vëmendja e opinionit nga dështimet e qeverisë në zbutjen e varfërisë, papunësisë apo mosshtrirjen e autoritetit në veri të vendit. Në dy, po tentohet që të monopolizohet e vërteta dhe historia duke ia atribuuar meritat për pavarësinë e vendit dhe të gjitha arritjet historike kryeministrit Thaçi dhe Partisë Demokratike të Kosovës.

---

<sup>1</sup> Raportet e Parlajmërimit të Hershëm të UNDP-së i nxjerrin varfërinë, papunësinë dhe korrupsionin si tri problemet më shqetësuese për qytetarët e Kosovës. Raporti nr. 20/21 Edicion Special Janar – Qershor 2008 <[http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/EWR20\\_alb\\_press.pdf](http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/EWR20_alb_press.pdf)> dhe “Fast Facts”, Early Warning Report 23. December 2008 [http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/Fast\\_Facts\\_23\\_EnglishFINAL.pdf](http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/Fast_Facts_23_EnglishFINAL.pdf)

Qeveria Thaçi kah fundi i 100 ditëshit të parë të saj duke iu përgjigjur presionit të opozitës për mungesë programi pat prezantuar në Kuvendin e Kosovës një dokument që vështirë se mund të quhet program qeveritar. Hulumtimet e opinionit të UNDP-së tregojnë një shpërputhje mes nevojave dhe interesave të qytetarëve të Kosovës dhe prioriteteve të Qeverisë Thaçi. Kjo qeveri është përqendruar në ndërtimin e rrugëve dhe shkollave sepse ato janë objekte që shihen dhe preken, prandaj kanë ndikim në krijimin e një perceptimi pozitiv mbi qeverinë. Konkludimi është i pashmangshëm se PDK-ja është fokusuar në ndërtimin e një imazhi publik të përkryer që, si duket, reflekton obsesionimin e shefit të saj me pamjen e tij të jashtme.

### **Qeveria e PDK-së**

Përveç ndërtimit të imazhit pozitiv publik për të fshehur shkeljet, qëllim tjetër duket se ka qenë forcimi i PDK-së si parti, nënshtrimi i partnerit qeverisës, LDK-së, dhe heshtja e çfarëdo opozite. Përderisa çdo prerje shiriti e Ministrisë së Arsimit dhe asaj të Transportit është përcjellur me bujë mediale, Ministria e Shëndetësisë është raportuar në media vetëm për dështime. Një mënyrë e tillë raportimi në media ngre dyshimin se ministrinë e PDK-së janë favorizuar kundruall ministrive të LDK-së. Natyrisht që kjo është arritur duke ndikuar direkt tek mediat e afërta apo nën kontrollin e qeverisë si dhe në mënyrë indirekte tek mediat jashta orbitës së saj.<sup>2</sup> Në një nga televizionet e Kosovës ministri i transportit, Fatmir Limaj, ishte pyetur në intervistë nga gazetari sesi e vlerësonte ministri punën e vetë të suksesshme.

Një konkludim i tillë se kjo qeveri është e PDK-së dhe se LDK-ja i është nënshtruar partnerit të madh të koalicionit, mund të nxirret edhe duke analizuar ndarjen e buxhetit për vitin 2009. Ministria e Transportit ka marrë nga buxheti për këtë vit gjithsej 115,981 milion euro nga të cilat për rehabilitimin e rrugëve dhe për ndërtime të reja të rrugëve mbi 76 milion euro.<sup>3</sup> Ministria e Shëndetësisë ka marrë rreth 66 milionë euro nga të cilat vetëm 11 milionë euro për listën e barnave esenciale, ndërsa sipas zyrtarëve të kësaj ministrie duhen së paku 30 milion euro për të mbuluar tërësisht nevojat për barnat esenciale.<sup>4</sup> Ndarja e buxhetit 2009 qartazi tregon favorizimin e ministrive të PDK-së me ç'rast edhe vitin e ardhshëm do të shohim shumë prerje shiritash dhe do të vazhdojmë të vuajmë për mungesë barnash esenciale si pasojë e luftërave politike.

Një kontrast tjetër i qartë bardh-e-zi që nxjerr në pah favorizimin e ministrive të PDK-së kundruall atyre të LDK-së mund të vërehet nga mbulimi që i bëhet në media Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ). MPB-ja lirisht do të mund të quhej edhe Ministria e Vulave sepse ministri Pajaziti më shumë ka vulosur pasaporta sesa që është marrë me sundimin e ligjit. Kjo ministri nuk e ka parë të udhës që të shprehet për gjendjen në veri apo të ndërmarrë ndonjë inisiativë dhe të fillojë të sillet si ministri e rendit, përveç një improvizimi hollivudian me forca speciale në Lagjen e

---

<sup>2</sup> Edhe Raporti i Progresit për Kosovën (2008) i Komisionit Evropian e thekson se ka presion politik ndaj mediave dhe se liria e shprehjes në Kosovë mbetet e cënuar. Faqe 19.

[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/press\\_corner/key\\_documents/reports\\_nov\\_2008/kosovo\\_progress\\_report\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/press_corner/key_documents/reports_nov_2008/kosovo_progress_report_en.pdf)

<sup>3</sup> KOHA Ditore “Qeveria nuk po dinë ta menaxhoj buxhetin”, 4 nëntor 2008.

<sup>4</sup> KOHA Ditore “Për asfalt para sa të duash, për barna s’ka”, 6 nëntor 2008.

Boshnjakëve. Megjithatë, ministri Pajaziti është mbuluar rregullisht nga mediat në vulosjen e pasaportave, gjithmonë i buzëqeshur.

Ministri i punëve të jashtme, në anën tjetër, Skënder Hyseni, ka qenë caku i preferuar i sulmeve mediale dhe “analitike”, sidomos nga mediat pro-qeveritare. E tërë barra e mosnjohjeve të mjaftueshme të pavarësisë së Kosovës është hedhur tek ai dhe ai vetëm është konsideruar përgjegjës për këto mosnjohje. Shumë rrallë ose aspak nuk janë mbajtur përgjegjës kryeministri Thaçi dhe presidenti Sejdiu për dështimet në politikën e jashtme. Tashmë është bërë zakon në opinionin kosovar që të sulmohen të “dobët”, ata që nuk kanë mbrojtje politike. Me parti të përçarë dhe kryetar të zënë ngusht për karrige, ministrat e LDK-së janë jetimat e kësaj qeverie.

### **Arrestimet spektakolare dhe mungesa e rasteve në gjykata**

Përgjatë gjysmës së dytë të vitit 2008 ka pasur një numër të madh të rasteve kur policia ka bërë burgosje spektakolare si konsekuencë gati direkte e deklarimeve akuzuese të kryeministrit për ndonjë kompani apo institucion. Kështu, në mars të vitit të kaluar u burgos ish-drejtori menaxhues i Aeroportit të Prishtinës dhe në vend të tij Bordi i ri i dominuar nga njerëz të PDK-së vendosi Agron Mustafën një person tjetër i afërt me po këtë parti. Përkundër burgosjes spektakolare dhe prononcimit të qeverisë dhe kryeministrit se kjo është në vazhden e luftimit të korrupsionit asnjëherë nuk u krijua një rast për gjykatë.

Rast tjetër i arrestimit spektakolar që nuk u finalizua me ndonjë rast të rëndësishëm për gjykatë ka qenë arrestimi i gjashtë doganierëve pikërisht ditën kur qeveria u detyrua ta kthej mbrapa vendimin e saj për shkarkimin e drejtorit të doganave Naim Huruglicën. Poashtu, në kohën kur u bë një presion publik ndaj qeverisë se nuk po ndërmerr masa kundër kontrabandimit në veri u burgosën një grup prej gjashtë vetave për kontrabandim të naftës, por edhe kjo ngeli si rast tejet i dyshimt duke qenë se nuk u veprua fare në parandalimin e kontrabandimit të karburanteve.

Ka pasur edhe burgosje të tjera të tilla spektakolare në të cilat gjithmonë kryeministri Thaçi vetë ose dikush nga qeveria kanë dalur për të pohuar se janë bërë në kuadër të luftës kundërkorrupsion. Megjithatë, të gjitha këto kanë ngelur vetëm në këtë nivel dhe të gjithë të burgosurit janë liruar pas një kohe relativisht të shkurtër kryesisht në pamundësi për të gjetur evidenca ose me ndikime direkte politike. E vërteta e pakontestueshme në këto burgosje është se Qeveria dhe kryeministri Thaçi gjithmonë janë kujdesur që të fitojnë kredit para opinionit kosovar duke shitur këto burgosje si shprehje të vendosshmërisë për mbisundim të ligjit. Të njëjtat media që raportojnë me pompozitet marrjen e kreditave nga ana e Qeverisë pothuajse nuk e mbulonin fare faktin se këto burgosje nuk arritën të finalizohen kurrë në gjykata dhe as faktin se shpesh burgosjet janë përdorur thjesht për të pastruar një strukturë në kompani publike apo institucione dhe për t'i zëvendësuar po ato me njerëz partiak.

Burgosja spektakolare e tre pjestarëve të shërbimit gjerman të intelegjencies poashtu ka qenë një rast që praktikisht i ekplodoi në dorë qeverisë së Kosovës në lidhje me shpërthimin në oborrin e ICO-së ndodhur në nëntor të 2008. As sot e kësaj dite nuk u

bënë të qarta rrethanat në të cilat u burgosën këta persona, burgosje kjo që i kushtoi shumë Kosovës dhe marrëdhënieve të saj me Gjermaninë, në njërën anë, por edhe rasti i shpërthimit ngeli një mister duke i kontribuar edhe më tutje një imixhi të keq të Kosovës.

### **Luftimi i korrupsionit me retorikë**

Qeveria Thaçi gjatë gjithë kohës prejse ka marrë mandatin për qeverisjen e vendit në retorikë i ka shpallur luftë krimit të organizuar dhe korrupsionit. Aspak nuk ka avancuar në praktikë zotimi i Qeverisë përveç se në aspektin deklarativ. Përkundrazi, nëse analizohen veprimet e Qeverisë për sa i përket ndërtimit të kornizës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar vërtetohet se politikat e saj kanë krijuar hapësirë që pikërisht njerëzit e kësaj Qeverie si dhe subjektet e lidhura me të të përfshihen në akte korruptive dhe në krim të organizuar. Raporti i Progresit (2008) për Kosovën i Komisionit Evropian vlerëson se korrupsioni mbetet problem i përhapur dhe serioz në Kosovë dhe se mungon vullneti për ta luftuar atë.<sup>5</sup> Ky fakt mund të vërehet më së miri po që se shihet qasja e Qeverisë në aprovimin e ligjeve bazike që për qëllim kanë parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Me propozim të Qeverisë si dhe me miratim të Kryesisë së Kuvendit janë tërhequr nga procedura e nënshkrimit nga ana e kryetarit të vendit dy ligje substanciale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ligji për Deklarimin dhe Prejardhjen e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik si dhe Ligji për Financimin e Partive Politike në Kosovë janë kthyer sërish në proceduat fillestare të shikimit pa një arsyetim objektiv për këtë vendim<sup>6</sup>. Infrastruktura ligjore në fuqi është e mangët dhe jo adekuate<sup>7</sup>, e janë pikërisht këto dy ligje si dhe amandamentimi i atyre ekzistuese të cilat do ta plotësonin kuadrin ligjor dhe institucional kundër korrupsionit.

Sot e kësaj ditë, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) nuk ka bërë publike burimet e financimit të saj. Për më shumë, PDK-ja në vazhdimësi ka shkelur afatet kohore të përcaktuara nga OSBE-ja mbi deklarimin e financimit të fushatës zgjedhore. Kjo tregon se PDK-ja si partia më e madhe në vend ka vendosur një precedent për injorim total të obligimeve të saja si subjekt politik si dhe ka bërë shkelje të vazhdueshme të parimeve të qeverisje së mirë, transparencës dhe përgjegjësisë. Nuk mund të pretendohet luftim kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit po që se partia e cila e drejton Qeverinë nuk bën publike financat e saja. Veç kësaj, opinionin publik asnjëherë deri më tani nuk është njoftuar me pasurinë e zyrtarëve të lartë të partive politike në Kosovë. Kjo për faktin se Ligji kundër Korrupsionit nuk parasheh (por as nuk parandalon) publikimin e pasurisë së zyrtarëve publik. Në këtë kontekst, vendimi i Qeverisë për tërheqje të dy ligjeve të sipërpërmendura qartazi tregon se deklaratimet sistematike të Qeverisë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit janë vetëm një retorikë shterpe e cila nuk do të materializohet në praktikë.

---

<sup>5</sup> Raporti i Progresit për Kosovën (2008), Komisioni Evropian.  
[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/press\\_corner/key-documents/reports\\_nov\\_2008/kosovo\\_progress\\_report\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/press_corner/key-documents/reports_nov_2008/kosovo_progress_report_en.pdf)

<sup>6</sup> Ligji për Deklarim dhe Prejardhjen e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik ka qenë i paraparë të miratohet në fund të viti 2008 sipas Planit të Veprimit për Parandalimin e Ekonomisë Joformale në Kosovë. Shih f.13.

<sup>7</sup> [http://www.cohu.org/raporte/COHU\\_Infrastruktura\\_ligjore.doc](http://www.cohu.org/raporte/COHU_Infrastruktura_ligjore.doc)

Në fillim të këtij viti, qeveria aprovoi Strategjinë kundër Korrupsionit për periudhën kohore 2009-2011. Duhet të thuhet se Qeveria u mundua t'i marr meritat për këtë Strategji edhe pse ajo është përpiluar në tërësi nga Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit. Për më tepër, kjo Strategji nuk është e bazuar në një hulumtim paraprak i cili do të pasqyronte natyrën e korrupsionit në Kosovë, mënyrën dhe formën e paraqitjes si dhe nivelin e shtrirjes. Por, është tërësisht e bazuar në hulumtime të organizatave ndërkombëtare e të cilat japin kryesisht informacione mbi perceptimet e qytetarëve mbi korrupsionin në Kosovë. Në këtë kuptim, nuk mund të pretendohet se vetëm mbi këto informacione mund të ndërtohet një Strategji kundër korrupsionit pa të dhëna të cilat mundësojnë krijimin e politikave që u përgjigjen rrethanave tona. Kjo Strategji si ajo për periudhën kohore 2004 – 2007 ka rrezik të mbetet vetëm një letër e vdekur pa një efekt praktik në realitet.

Në vazhdimësi lidhshipi politik në Kosovë është fokusuar vetëm në aprovimin kuantitativ të ligjeve si dhe në krijimin sipërfaqësor të institucioneve kundër korrupsionit. Kjo për arsye se individ brenda politikës si dhe të lidhur me të kanë qenë direkt të përfshirë në akte korruptive dhe krim të organizuar dhe kështu ka munguar vullneti politik për krijimin dhe implementimin e politikave kundër korrupsionit dhe të krimit të organizuar.

### **Shitja e opozitës**

Opozita e Kosovës vazhdon të karakterizohet nga apatia, e ç'orientuar totalisht, me reagime sporadike në parlament por më shumë me konferenca shtypi. Kjo opozitë vazhdon të mbetet peng e të kaluarës së saj ose e interesave ekonomike. Aleanca Kosova e Re (AKR) e Behxhet Pacollit u fut në shtrat me qeverinë kur kompania e zotit Pacolli, Mabetex, mori një tender nga qeveria për renovimin e ndërtesës së Pallatit të Shtypit në vlerë prej 15 milionë eurosh. Natyrisht pasojë e kësaj është heshtja e AKR-së si opozitë duke tradhtuar kështu qytetarët të cilët ia kishin dhënë votën kësaj partie në emër të përfaqësimit të interesave të tyre në Kuvendin e Kosovës dhe keqpërdorimi i parasë publike. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) vazhdon të mbetet peng i të kaluarës së saj kur ministrat e kësaj partie në qeverinë e kaluar ishin përfolur për korrupsion dhe Zyra e Auditorit Gjeneral kishte konstatuar “zhdukje” milionash në resorët që ata udhëhiqnin. Pa një spastrim të gjerë brenda kësaj partie zor se ajo do të mund të krijojë bagazh moral të mjaftueshëm për të bërë opozitë të mirëfilltë në Kuvend. Në një situatë të ngjajshme gjindet edhe Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD) por më shumë e karakterizuar nga apatia dhe snobizmi i shefit të saj i cili më shumë se të bëjë opozitë është i preokupuar me paraqitjen e tij si profeti i shpëtimit të Kosovës.

### **Kuvendi i nënshtruar**

Kosova ka mbetur pa zë opozitar dhe pasojat e kësaj mungese krijojnë parakushtet për një dominim të përgjithshëm të qeverisë që është një tokë pjellore për zhvillimin e autoritarizmit, sidomos kur mirret parasysh futja nën kontroll e resurseve kyçe financiare, nënshtrimi i agjensioneve të pavarura, një pjese të mediave dhe shoqërisë civile. Lufta në parlament dhe jashta tij në konferenca shtypi nga partitë politike është më shumë një luftë për mbrojtjen e interesave ekonomike sesa të interesave të qytetarëve. Asnjë parti opozitare në parlament nuk e ngre zërin për projektin Kosova C, të riemëruar



së fundi nga kryeministri Thaçi si Kosova e Re, për të pyetur se cili do të jetë interesi dhe përfitimi i qytetarëve të Kosovës nga ky projekt; asnjë parti opozitare nuk e ngre zërin kundër shitjes së PTK-së e cila bashkë me Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës është ndër kompanitë e vetme që kontribuojnë fuqimisht në buxhetin e Kosovës; asnjë parti nuk del në mbrojtje të pasurive strategjike të Kosovës; asnjë parti nuk ka kërkuar debat për mënyrën sesi janë privatizuar pasuritë e Kosovës deri më sot apo për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Asnjë parti politike në Kosovë nuk shqetësohet nga varfëria ekstreme dhe papunësia e gjysmës së popullit të Kosovës. Deputetët e Kuvendit të Kosovës janë të shqetësuar për privilegjet e tyre dhe mënyrën sesi të sigurojnë sa më shumë të ardhura. Kuvendi i Kosovës është një fushëbetejë interesash ekonomike gjysëm-legale të partive politike dhe jo të interesave të qytetarëve. Ky Kuvend ka dështuar dhe është vënë tërësisht nën shërbim të ekzekutivit të vendit.

### **Cënimi i pushteteve të pavarura**

Agjensionet të cilat me kushtetutë janë të pavarura, janë cënuar nga kjo qeveri dhe disa prej tyre tashmë janë nën kontrollin e plotë të kësaj qeverie. Agjensioni Kundër Korrupsionit ka qenë cak i tentimeve të qeverisë për nënshttrim dhe kontrollim, sidomos në muajin korrik kur zëvendëskryeministri Kuçi tentoi të heshtë këtë Agjensioni pasi që kishte publikuar një raport ku qeveria e Kosovës dhe gjyqësori prinin përse i përket rasteve të dyshuara për korrupsion. Agjensioni i Akreditimit dhe Organi Shqyrtues i Prokurimit tashmë janë nën kontrollin e qeverisë me persona politik të përzgjedhur nga ministrat e caktuar si kryeshefa ekzekutiv dhe anëtarë të tyre. Administrata Tatimore e Kosovës dhe Agjensioni i Privatizimit i Kosovës udhëhiqen nga një shef i një dege të PDK-së, përkatësisht nga një person në konflikt interesi si i favorizuar nga kryeministri Thaçi.<sup>8</sup>

### **Strukturat paralele, EULEXI dhe integriteti territorial**

Megjithëse shpallja e pavarësisë ishte një moment i kapur mirë dhe solli një avantazh në dukje të parë, u pa qartë se as qeveria dhe as spektri politik kosovar nuk ishte i përgaditur për t'iu përgjigjur veprimeve të Serbisë pas Deklaratës së Pavarësisë. Ngjarjet që pasuan dhe aktiviteti diplomatik dhe praktik i Serbisë sollën një ndryshim të tërësishëm të situatës duke shndërruar avantazhin në një përmbysje të plotë. Kjo praktikisht ktheu mbrapa vendosshmërinë e sferës përëndimore për të pranuar dhe implementuar pavarësinë e Kosovës dhe për ta ruajtur integritetin territorial. Fakti që çështja e Kosovës u kthye në KS të OKB-së dhe që kampi i përkrahësve të pavarësisë së Kosovës filloi t'iu përgjigjej përditë e më shumë kërkesave ruse e serbe u injorua tërësisht nga Qeveria e Kosovës por edhe nga opozita. Për pasojë Kosova sot përballohet me një mungesë serioze të perspektivës si shtet dhe me një ndarje jo vetëm faktike por tashmë edhe formale të një pjese të madhe të territorit të saj. Sjellja e qeverisë në mënyrë autoritare duke provuar që ta kontrollojë informacionin që tregon realitetin rreth kërcënimit të tërësisë territoriale dhe të statusit nuk e ndihmoi por e përkeqësoi situatën. Tashmë është evident fakti se pjesa e mbetur pa ligj, ose më saktë e thënë pjesa e territorit e administruar nga Serbia

---

<sup>8</sup> Për më shumë mbi kontrollin në institucionet e pavarura shih raportin e Organizatës COHU! mbi 200 ditëshin e Qeverisë Thaçi "Shtrirja e kontrollit me qëllim të fshehjes së korrupsionit"  
[http://www.cohu.org/raporte/200diteshi\\_QeveriaThaci\\_final\\_COHU.doc](http://www.cohu.org/raporte/200diteshi_QeveriaThaci_final_COHU.doc)

është duke shërbyer për sabotim të përpjekjeve për ndërtim të shtetit dhe ligjit të Kosovës.

Në anën tjetër gjatë tërë tetorit, nëntorit dhe dhjetorit të vitit të kaluar Qeveria ka provuar ta bind opinionin publik se EULEX do të sjellë mbisundim të ligjit në pjesën e territorit ku ndikimi i Serbisë kishte kohë që ishte shtrirë. Kështu, tërë shpresat e Qeverisë së Kosovës mbi këtë problem u kufizuan në të ashtuquajturen “shtrirje e EULEX-it”, e cila, siç u provua gjatë fundit të vitit 2008 dhe fillimit të vitit 2009, nuk do të sigurojë ligjshmëri në këtë pjesë por, përkundrazi do të jetë një mbrojtje shtesë e strukturave paralele serbe dhe e kthimit të legjitimitetit serb në Kosovë nëpërmjet autoritetit të UNMIK-ut. Praktikisht EULEX-i nuk bëri asnjë hap për zhbërjen e strukturave paralele por me t’u “shtrirë” e shpalli si prioritet të prioriteteve luftimin e krimeve të luftës që nga qasja e derisotshme e ndërkombëtarëve është parë që ka nënkuptuar nxjerrjen para organeve të drejtësisë të ish-pjestarëve të UÇK-së. Ndërsa për vrasjet, djegiet dhe sulmet ndaj pronës private dhe ndërtesave publike të bërë nga serbët qysh prej shpalljes së pavarësisë së Kosovës, asnjë person nuk u përballua me drejtësinë deri sot.

Kohëve të fundit po përgatitet edhe një raund tjetër bisedimesh mes përfaqësuesve të Kosovës dhe Serbisë, i cili nga këndvështrimi i organizatorit të këtyre bisedimeve, UNMIK-ut, është raund për zbatimin në praktikë të Gjashtëpikëshit të Ban Ki Moon, kurse nga këndvështrimi i qeverisë së Kosovës është një bisedim i dy shteteve sovrane. Megjithatë është fakt se këto bisedime janë duke u moderuar nga UNMIK-u, i cili praktikisht përfaqëson linjën politike të KS të OKB-së, i cili tashmë edhe zyrtarisht njeft barazinë e legjitimitetit të strukturave paralele serbe në Kosovë dhe të atyre të Qeverisë së Kosovës (Komunikata e OKB-së për stafin e UNMIK-ut, Koha ditore: “Për OKB-në nuk ka struktura paralele në Kosovë). Opozita po vazhdon ta shfrytëzojë situatën dëshpëruese në veri për të bërë fushatë dhe luftë për pushtet. Në asnjë moment partitë opozitare nuk kanë pasur guxim të flasin për rolin e EULEX-it në pjesën veriore, por vazhdimisht kanë konstatuar se gjendja atje është jashta kontrollit të Qeverisë së Kosovës. Partitë opozitare esencialisht nuk kanë dalë në pengim të zbatimit të Gjashtëpikëshit duke përcjellur në këtë mënyrë linjën e përcaktuar nga bashkësia ndërkombëtare për tërë politikën kosovare që nënkupton bindje dhe dëgjueshmëri ndaj tyre pa ndonjë dyshim.

Përfundimisht pjesa veriore e Kosovës nuk ka mbisundim të ligjit. Serbët pothuajse janë të lirë të sulmojnë shqiptarët që jetojnë në këtë pjesë dhe pronat e tyre dhe ata nuk trajtohen fare nga organet e rendit as ato kosoavre dhe as ato ndërkombëtare. Përgjithësisht reagimi i ShPK-së dhe njësiteve speciale të saj ka qenë me burgosjen e shqiptarëve. Burgosja vetëm e shqiptarëve për incidente të cilat nga të gjithë konsiderohen si të shkaktuara nga serbët po i kontribuon në nxirjen e imixhit të Kosovës dhe të shqiptarëve në arenën ndërkombëtare. Kjo gjë u arrit edhe me një burgosje tjetër spektakolare që ndodhi që bënë njësitet serbe speciale në rajonin e Preshevës gjatë festave të fundvitit.

## **NDËRMARRJET PUBLIKE**

### **Privatizimi i ndërmarrjeve publike**

Qeveria ka filluar procesin e privatizimit dhe dhënies me koncesion të Ndërmarrjeve Publike, PTK, KEK dhe ANP, kompani këto fitimprurëse dhe të një rëndësie të madhe për vendin. Bazuar në vendimet e derisotshme, duket se procesit të privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore nga AKM-ja do të jetë një prelud për privatizimin edhe të ndërmarrjeve publike. Ky proces do të udhëhiqet nga po të njëjtit njerëz që udhëhoqën procesin e privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore. Ahmet Shala, zëvendës drejtor për NSH-të në AKM, sot në pozitën e ministrit për Ekonomi dhe Financa do jetë personi që do e japë fjalën e fundit për privatizimin e Ndërmarrjeve Publike.

Vetë Shala, paradoksalisht ka deklaruar disa herë se privatizimi i ndërmarrjeve publike nuk do të shkojë si privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore<sup>9</sup> duke mos dhënë asnjë shpjegim se pse i njëjti njeri pas tetë vjetëve qëndrimi në krye të këtij procesit po e konsideron edhe vetë të dështuar atë dhe cilat janë garancat se e njëjta nuk do të përsëritet tashti. I gjithë privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë u realizua në emër të një zhvillimi ekonomik i cili kurrë nuk u pa, për me tepër rezultoi pothuajse totalisht i dështuar. Një e treta e numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve të privatizuara në Kosovë nuk funksionojnë<sup>10</sup>. Në anën tjetër kompanitë më të rëndësishme të privatizuara, siç janë Ferronikeli dhe Llamkosi, si dhe shitja e frekuencave për operatorin e dytë të telefonisë mobile, nga këndvështrimi i interesit publik jo që nuk rezultuan me një zhvillim, por u dëshmuan si të dështuara dhe i kushtuan në vend që t'i sjellin dobi Kosovës.

Fondet e akumuluar nga shitja e ndërmarrjeve shoqërore arrijnë shumë prej 383 milionë eurosh dhe mbahen të bllokuara nga AKM-ja dhe jashtë aktivitetit ekonomik të vendit. Sipas ekspertëve ligjorë të Kombeve të Bashkuara dhe ekspertëve vendorë, rreth 80 % e 400 milion eurove të grumbulluara nga shitja e ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë, do t'u takojnë kompanive në Serbi<sup>11</sup>.

Ende nuk ka një studim të mirëfilltë që do të pasqyronte performancën e ndërmarrjeve të privatizuara dhe pasojat e këtij procesi në aspektin ekonomik dhe shoqëror. Por, ky proces shkaktoi pasoja dhe në aspektin social. Privatizimi në Kosovë nuk zbuti papunësinë dhe 20% që iu premtua punëtorëve nuk u shpërndan.

### **Respektohen interesat e kompanive që privatizojnë e jo ato të publikut**

Ferronikeli është një shembull prezantues i mënyrës se si ka rezultuar privatizimi në Kosovë. Kjo ndërmarrje, përkundër faktit që nga qeveria e kaluar dhe nga kryesuesi i bordit të AKM-së Paul Acda<sup>12</sup> që trumbetuar si rasti më i suksesshëm i privatizimit, për shkak të kontratës së dëmshme të nënshkruar nga AKM dhe Qeveria e Kosovës, kontribuoi në rënien e mëtutjeshme të zhvillimit duke i shkaktuar Buxhetit i Kosovës

<sup>9</sup> Intervistë, RTV21, Emissioni “Sy më Sy”, Nëntor 2008

<sup>10</sup> Forum 2015, “Privatizimi dhe post privatizimi në Kosovë”, shtator 2008, Prishtinë, fq 16

<sup>11</sup> Express, 18 gusht 2008, fq 10 Arben Hyseni

<sup>12</sup> ECIKS - Neës and analysis about Kosovo Economy in English.htm

rreth 20 milionë euro humbje për çdo vit<sup>13</sup>, ndërsa i tërë Ferronikeli është privatizuar për vetëm 30.5 milionë euro<sup>14</sup>. Ministri Ahmet Shala, udhëheqës i AKM-së në atë kohë, vitin 2005, pati thënë se vlerën e Ferronikelit e përcakton tregu<sup>15</sup>, e që të njëjtin qëndrim po mban edhe tash për PTK-në.

Në këto kushte dhe nga të njëjtit njerëz rrezikon që kompanitë publike kosovare të shiten me çmime banale, kurse përfitimi nga to të shkojë jashtë Kosovë e Kosova vetëm të humb në vend se të fitojë nga to. Manipulimi të procesit të privatizimit qëndron në atë se për shkak të korrupsionit marrëveshjet për privatizim respektojnë kërkesat e investuesve, por jo edhe interesat e qytetarit dhe ekonomisë së Kosovës. Sot, Qeveria e Kosovës thjesht po tregohet e pafuqishme të veprojë për të ndalur dëmet e mëtutjeshme nga privatizimi duke i paraqitur kontratat si të panegociushme.

### **Politizimi i ndërmarrjeve publike**

Politizimi i Ndërmarrjeve Publike që edhe njëra ndër pikat që u kritikua në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian, por qeveria, edhe përkundër hapjes së konkursit për bordet e kompanive publike praktikisht vetëm sa janë konfirmuar funksionarë partiak të PTK-së, LDK-së dhe SHIK-ut edhe në borde por edhe në pozita udhëheqëse të kompanive siç ishte ajo e drejtorit aktual të Aeroportit. Shembulli tjetër më eklatant i politizimit është vendosja e një ish-drejtorit të SHIK-ut si drejtor në Trepça. Ferat Shala ish-drejtor financiar i SHIK-ut është vendosur drejtor i Trepçës edhe përkundër faktit se ai gjendet në konflikt interesi duke qenë se bashkëshortja e tij, Sala Shala është anwtare e Komisionit parlamentar të Minerave.

Në anën tjetër ngelet krejtësisht misterioz roli i këshilltarit të kryeministrit Thaqi, Arie Rabfogel, i cili me bizneset e tij është i përfshier që nga dhënja e licesave për hulumtime minerare jashta pronave të Ferronikelit e gjer tek Komiteti drejtues për termocentralin Kosova e Re/Kosova C

### **Post Telekom i Kosovës - PTK**

Politikat e qeverisë në raport me këtë kompani kanë qenë tepër të dëmshme. Së pari është vendosur një ndikim i fortë në Qeveri i sektorit privat gjegjësisht kompanive që janë në konkurrencë me PTK-në dhe këto ndikime e kanë dëmtuar shumë këtë kompani. Me të ardhur kjo qeveri ministri Limaj pat filluar fushatën për uljen e pagave të menaxhmentit të kompanive publike dhe sidomos të PTK-së. Edhe pse kjo gjë nuk u bë asnjëherë ky presion frikësoi një pjesë të menaxhmentit të PTK-së, të cilët thjesht kaluan në kompaninë konkurrencte pa ndonjë masë të ruajtjes së interesit të operatorit publik të telefonisë. Tashmë, është raportuar për një rënje të të hyrave të PTK-së që vetëm për vitin e kaluar llogaritet të jetë minimum 10%, por vlera e përgjithshme e kësaj kompanie është reduktuar vazhdimisht<sup>16</sup>. Ekspertët mendojnë se nëse vazhdon kjo mënyrë e menaxhimit

<sup>13</sup> Infopress, “KEK-u llaston “Ferronikelin”, 17 shtator 2008, fq 4

<sup>14</sup> <http://www.unmikonline.org/pub/focuskos/jan06/focuskeco1.htm>

<sup>15</sup> <http://kosovareport.blogspot.com/2005/05/kosovo-us-albanian-firm-buys-feronikel.html>

<sup>16</sup> [http://www.cohu.org/index.php?option=com\\_content&view=article&id=88:operatori-publik-shkaterrohet-ska-qeveri-qe-ta-mbroje-ate-per-shkak-te-ndikimit-politik&catid=3:komunikata&Itemid=3](http://www.cohu.org/index.php?option=com_content&view=article&id=88:operatori-publik-shkaterrohet-ska-qeveri-qe-ta-mbroje-ate-per-shkak-te-ndikimit-politik&catid=3:komunikata&Itemid=3)

vlera e PTK-së mund të bie gjer në masën 70%, gjë që do ta bëjë publikun kosovar të jetë humbës i qindra miliona eurosh.

Bordi krejtësisht politik i PTK-së ka nënshkruar një marrëveshje që sipas asaj që është bërë publike Dardafonit i jepet për të operuar deri në 78% të biznesit të Valës brenda të ashtuquajturit shërbimi Mobile Virtual Netëork Operator (MVNO). Kjo marrëveshje e arritur në mënyrë tejet jotransparente praktikisht përcakton kushte krejtësisht të disfavorshme dhe të dëmshme për PTK-në ashtu siç edhe kanë alarmuar një grup punues nga PTK-ja në një raport vlerësimi të marrëveshjes<sup>17</sup>. Nënshkrimi i kësaj kontrate atë kohe u bë edhe kusht për personin që do emërohet drejtor i PTK-së.

Pas një kohe të gjatë të lënjes së PTK-së pa drejtor menaxhues qeveria ka vendosur një kandidat duke i dhënë fund një manipulimi të hapur të qeverisë me qëllim të vendosjes së ndikimit direkt në këtë kompani. Drejtori i zgjedhur Shyqyri Haxha, me të hyrë në këtë pozitë, i dha të gjitha shenjat se do të injorojë zërat e ekspertëve të kësaj fushe dhe do të përqafojë ndikimin direkt të qeverisë në menaxhim. Haxha praktikisht nuk ka qenë në zyrën e tij nëse përjashtohen katër-pesë vizita duke qenë se ai jeton në Londër së bashku me familjen e tij. Burimet thonë se sipas marrëveshjes Haxhajt i paguhen biletat e aeroplanit dhe mëditje shtesë që vetëm për rreth dy muaj kanë arritur një shpenzim prej rreth 20 mijë eurosh. Sido që të jetë, Haxhaj konfirmoi se do të nënshkruhet marrëveshja krejtësisht jotransparente dhe joligjore me Dardafon dhe së dyti u angazhua që të vazhdojë edhe procesi joligjor i privatizimit të PTK-së duke qenë se vendimin për privatizim në bazë të Ligjit për ndërmarrjet publike në vend që ta marrë Parlamenti e ka marrë Qeveria e Kosovës<sup>18</sup>.

Në bazë të intervistave të realizuara me ekspertë vërehet se ka një paqartësi të madhe rreth këtij vendimi për privatizim, nuk dihet arsyeja se pse me kaq nguti u morr ky vendim, e sidomos kur kriza financiare e bën këtë proces edhe më të pafavorshëm për PTK-në. Manipulimi i procesit të privatizimit të PTK-së është shumë i mundshëm kur kihet para sysh se akoma nuk është zhvilluar një strategji për privatizimin e Kompanive publike<sup>19</sup>. Ministri Shala ka deklaruar për media se “privatizimi i PTK-së do të jetë i tërësishëm ose i pjesshëm”<sup>20</sup>, gjë që tregon se akoma pa pasur një ide rreth privatizimit të kompanive publike është marrë vendimi për privatizimin e kompanisë më fitimprurëse publike, PTK-së. Poashtu nuk po përcaktohet një vlerë e PTK-së dhe thuhet se vlerën e saj do ta vendosë tregu, është një absurditet tjetër i këtij procesi duke qenë se praktikisht hapet mundësia që vlera e PTK-së të mos jetë e ditur për publikun kosovar. Kjo lë mundësinë për udhëheqësit e këtij procesi ta ulin pafundësisht vlerën e kësaj kompanie sidomos kur shifet se ata siç duket do t’iu binden zërave se kompanitë kosovare do të shiten me çmim më të ulët sesa ato të tregut. Në momente të ndryshme vlera e PTK-së ka qenë e ndryshme, por një vlerësim i përgjithshëm i bërë në fillim të vitit 2007 ka nxjerrë një vlerë të përafërt me 1 miliardë euro.

<sup>17</sup> Raporti i aspektit komercial të draftmarrëveshjes MVO PTK-Dardafon, Dokumenti i Bordit të Drejtorëve të PTK-së, 20.10.2008

<sup>18</sup> Neni 9.1, Ligji për ndërmarrjet publike

<sup>19</sup> Koha ditore, 11 shtator, 2008

<sup>20</sup> Kosova sot, Lajm, tetor 2008

### **Aeroporti i Prishtinës**

Pothuaj se në mënyrë konsekuente pas deklarimeve të kryeministrit Thaqi se kompanitë publike janë kampione në korrupsion u arrestua drejtori menaxhues i Aeroportit, për t'u zëvendësuar me një person të PDK-së së pari si ushtrues detyre dhe pastaj pa respektuar institucionin e konkursit publik vendoset si drejtor. Në mbështetjen për shkeljen e institucionit të konkursit, Bordi i Aeroportit ka përdorur një arsyetim qesharak, duke deklaruar për media se “për këtë është konsultuar Zyra Ligjore e Aeroportit”, e cila praktikisht ka qenë nën subordinim të ish u.d. tash drejtorit menaxhues të kësaj kompanie.

Me të ardhur në këtë post drejtori i aeroportit ka filluar një fushatë të re punësimi me dhe pa konkurs të njerëzve. Punësimi i njerëzve pa konkurs në Aeroportin e Prishtinës gjithmonë ka qenë një aspekt shumë problematik i kësaj kompanije, madje ka pasur edhe vrasje të lidhura me miton për punësime në këtë kompani<sup>21</sup>. Një incident i ndodhur kohë më parë në Prishtinë gjatë një feste të Aeroportit ku ngelën të plagosur me armë zjarri disa persona ka ngelur krejtësisht i pasqaruar për opinionin publik kosovar<sup>22</sup>

### **Korporata Energjetike e Kosovës**

Qeveria aktuale nëpërmjet presionit me shkyqje ka arritur të shtojë inkasimin e energjisë elektrike të shpenzuar, por kjo është bërë në baza diskriminuese duke qenë se nga kjo janë goditur vetëm komunitetet joserbe. Pengesa kryesore dhe rreziku më i madh që i është kanosur KEK-ut është pikërisht Qeveria e Kosovës edhe atë pa marrë para sysh kush ka qenë në pushtet. Kjo po ndodh për llogari të kompanive të huaja të cilat po përdorin edhe ndikimin politik të përfaqësive diplomatike në Kosovë. Kjo u pa më së miri në një Ëorkshop të organizuar nga USAID, në të cilën mori pjesë edhe vetë kryeministri Thaqi, ambasadorja Tina Kaidanov, ministrja e energjetikës Justina Pula dhe ministri i ekonomisë Ahmet Shala. Konsulenti i USAID, Michael Jake Delphia, derisa flitej për privatizimin e Rrjetit shpërndarës të KEK-ut iu tha përfaqësuesve të pranishëm të qeverisë se nuk do t'i marrin çmimet e rajonit për kompanitë publike<sup>23</sup>. Angazhimit të ekspertëve ndërkombëtarë për shitjen e kompanive publike me çmim më të ulët se rajoni i përgjigjet ministri Shala me një fjali faleminderuese duke thënë se “ne kemi nevojë për partner strategjik” edhe pse në këto privatizime Kosova nuk do të jetë partnerë duke qenë se qeveria është duke i përgaditur për shitje të tërsishme kompanitë publike.

Në anën tjetër, qeveria nuk është duke iu caktuar vlerën kompanive të veta por vazhdon me qëndrimin se vlerën këtyre kompanive do t'ua caktojë tregu. Në anën tjetër politikat e qeverisë ndaj KEK-ut tregojnë një qëllim tashmë të qartë që të mbyllën kapacitetet publike në energji për hapjen e atyre private të huaja, përkatësisht termocentralin Kosova e Re. Kjo është reflektuar edhe në draftin për Strategjinë për zhvillim të energjisë të Qeverisë së Kosovës, ku praktikisht qeveria ka hequr nga strategjia kërkesën që në

---

<sup>21</sup> OIOS: Report on Pristina International Airport, March 2006, Organizata ÇOHU!, Raport mbi ANP-në, Mungesa e Përgjegjësisë së Zyrtarëve të Lartë për Dënimin e Shkeljeve Gjatë Viteve 2000-2005

<sup>22</sup> Zëri, e shtunë, 1 nëntor 2008.

<sup>23</sup> Koha ditore, 10 dhjetor, “Qeveria Paralajmëron Privatizimin e KOSST”

investime të përbashkëta privato-publike dhe për përfshirjen e kapitalit vendor si dhe ka hequr kufizimin për kapacitetin e termocentraleve të reja që do të ndërtohen.

“Kosova e Re” si projekt ende vazhdon të shtrojë terrenin për tu implementuar, edhe pse asnjëherë nuk u diskutua nga Kuvendi, e në anën tjetër as Qeveria nuk ka dhënë kurrfarë shpjegimi se mbi çfarë baze mori vendim ta përkrah projektin . Ky projekt që do të nxjerrë tërësisht nga prodhimi kapacitetet vendore të prodhimit të energjisë duke futur investues të huaj. Në anën tjetër nuk rreshtin akuzat për KEK-un si gërmadhë e cila vetëm shpenzon nga buxheti i Kosovës. KEK-u është vlerësuar para disa viteve nga Deloitte & Touche dhe thuhet se ka vlerë diku rreth 6 miliardë eurosh<sup>24</sup>.

KEK-u ende nuk ka drejtor, por udhëhiqet nga ushtruesi i detyrës, përveç kësaj shtatë pozitë kyçe në Korporatën Energjetike të Kosovës udhëhiqen nga ushtrues detyre<sup>25</sup>. Përmirësime në KEK mund të vërehen vetëm sa i përket inkasimit, falë shkyçjeve që janë bërë në shumë vende.

Edhe vendimi i qeverisë për privatizimin e distribuimit dhe furnizimit ka paqartësi dhe nuk u dhanë sqarime se si erdhën deri tek ky përfundim, e sidomos kur as në këtë ndërmarrje nuk bëhet publike vlera e kësaj kompanie e as nuk posedohet ndonjë studim se si duhet të rrjedh ky proces<sup>26</sup>. Për më tepër ministri Ahmet Shala nuk e sheh të udhës as të marr pjesë në takimin e Komisionit për Energji dhe Miniera për të ofruar materialin mbi të cilin u morën këto vendime.

### **Sindikatat**

Qeveria e Kosovës gjatë vitit 2008 ndërmori disa hapa për rritjen simbolike të pensioneve, pagave të arsimtarëve, stafit civil të administratës e shumë premtime për sektorët tjerë. Gjatë këtij viti u hasën disa përpjekje të punëtorëve për organizimin e pakënaqësive të tyre duke filluar nga Ferronikeli në fillim vit, shëndetësia, punëtorët e Trepçës e deri tek policët. Hapat e ndërmarrë nga qeveria për rritjen e simbolike të pagave edhe ashtu tejet të ulëta më shumë ngjan me një politikë për shuarjen e çfarëdo revolte dhe ngritjeje të pakënaqësive nga ana e punëtorëve sesa rritje pagash për përmirësimin e mirëqenies së punëtorëve. Nënshkruheshin marrëveshje, e thureshin premtime, e pastaj realizimi i tyre bëhej varësisht vendosshmërisë së punëtorëve për të mos hequr dorë nga grevat deri në realizim të premtimeve. Policia e Kosovës as në vitin 2009 nuk do t'i gëzojnë beneficionet e veta, të cilat përcaktohen me ligj. Marrëveshja e nënshkruar në tetor të viti e kaluar mes Policisë së Kosovës dhe Qeverisë nuk do të zbatohet, ndërkaq policia në shenjë pakënaqësi të martën do të marrë vendim për daljen në protestë. Kjo para së gjithash po arrihet me manipulim të sindikatave në të gjithë sektorët.

Për aq kohë sa ishte në funksion AKM-ja personi i cili i përfaqësoi interesin e punëtorëve që Barhri Shabani, i cili ishte udhëheqës i BSPK-së në atë kohë. Duke e parë procesin e privatizimit se si rrodhi, ku përveç që në secilën ndërmarrje të privatizuar thuaja se u përgjysmua numri i punëtorëve, as kuota prej 20% e premtuar nuk iu nda punëtorëve. Përveç tjerat është po i njëjti person i cili tash vazhdon punën në të ashtuquajturin

---

<sup>24</sup> Izet Mustafa, BSPK

<sup>25</sup> Interviste , Izet Mustafa, BSPK

<sup>26</sup> Interviste, Myzejane Selmani, kryetare e Komisionit për Energji dhe Miniera

Agjensioni Kosovar i Privatizimit, AKP. Sipas raporteve të auditorit Bahri Shabani dyshohet për keqpërdorim të detyrës edhe sa ishte në BSPK si dhe për keqpërdorime në AKM. Madje ndaj tij edhe ka filluar një hetim i policisë, i cili, sipas burimeve tona nga policia ky hetim është ndaluar pa ndonjë shpjegim por me “një intervenim nga lartë”.

Partia në pushtet, PDK, derisa ishte opozitë kishte mjaftë akuza kundër zotit Shabani, por siç duket ministri Shala ndërroi qëndrimin e PDK-së kur Shabanin e propozoi si anëtar të Bordit të AKP-së si “ekspert i pavarur”. Kjo është edhe një indikator tjetër që shpalos një proces privatizimi që rezultoi i dështuar pasi që askush nuk ishte aty të mbrojë interesin e Kosovës e as të punëtorëve të saj. Sot e kësaj dite sindikatat kanë të vështirë ta marrin veten falë dëmeve që shkaktuan persona të tillë.



## **EKONOMIA: POLITIKA TE GABUARA DHE INJORIM I VARFERISE**

Përkundër premtimeve të shumta që Qeveria Thaci i bëri për zhvillim ekonomik, politikat dhe vendimet në një masë të dukshme e kanë demantuar atë në praktikë. Edhe pse në disa aspekte si ndërtim të infrastrukturës rrugore e shkollave janë pranuar përgjithësisht si zhvillime të reja në krahasim me gjendjen prej nga është nisur kjo qeveri, asnjëra nga këto nuk do të ndikojë dukshëm për një zhvillim të qëndrueshëm duke qenë se ato nuk janë bërë sipas një plani më të kompletuar e të integruar për zhvillim që do të garantonte qëndrueshmëri në zhvillim. Në anën tjetër një varg masash që do të kenë si rezultat rritjen e varfërisë dhe papunësisë janë bërë ose nën ndikim të qendrave të ngushta të interesit ose nën ndikim direkt politik të sektorit privat. Investimet në infrastrukturën rrugore e në shkolla janë përcjellur me mungesë serioze të transparencës, kurse një numër tenderësh në fusha tjera janë përcjellur edhe me shkelje serioze të ligjit.

Raporti i Paralajmërimit të Hershëm i UNDP-së (qershor 2008) nxjerr papunësinë dhe varfërinë si dy brengat kryesore që i shqetësojnë mbi të gjitha qytetarët e Kosovës.<sup>27</sup> Ky raport tërheq vërejtjen se afër 70% e qytetarëve të Kosovës janë të gatshëm të protestojnë për shkaqe ekonomike dhe pothuajse gjysma e tyre janë të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me mënyrën sesi shpenzohet Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. Edhapse kënaqshmëria me punën e qeverisë prej qershorit deri në nëntor 2008 është rritur nga 50% në 57% sipas hulumtimit të opinionit Fakte të Shpejta të UNDP-së (dhjetor 2008), i njëjti hulumtim tregon për një rritje kritike të gatishmërisë për të protestuar për shkaqe ekonomike, nga 70% në 78%, dhe një rritje të gatishmërisë për të protestuar për shkaqe politike nga 49% në 60%.<sup>28</sup> Edhe ky hulumtim i konfirmon papunësinë dhe varfërinë si dy shqetësimet më të mëdha të qytetarëve të Kosovës, por tash korrupsioni është ngritur në shqetësimin e tretë nga i pesti sa ishte në qershor. Një hulumtim mbi korrupsionin i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë ka zbuluar se 66% e bizneseve në Kosovë duhet t'u ofrojnë mito zyrtarëve institucional për të fituar tenderë.<sup>29</sup>

### **Punësimi në ndërtimin e rrugëve – a është zhvillim?**

Konstatimi më i shpesht i kësaj qeverie kur ka folur për ekonomi ka qenë, sipas tyre, punësimi i mijëra punëtorëve në kompanitë që po ndërtojnë rrugë të finansuara nga Ministria e Transportit. Natyrisht kjo mund të pranohet si një zhvillim pozitiv në krahasim me gjendjen prej nga ka filluar kjo qeveri por shtrimi i rrugëve pa parë prioritetet për investime dhe pa studiuar sa do të ndihmojë në zhvillim ekonomik nuk ngelet gjë tjetër veqse një mënyrë e thjesht për t'i ikur suficitit që shkaktohet për shkak të mungesës së projekteve. Shtrimi i rrugëve dhe ndërtimi i shkollave është një veprim relativisht i thjesht i qeverisjes dhe nuk nënkupton ndonjë zhdërvjelltësi të theksuar përveçse një shpenzim i pa konsideratë dhe pa plan i parasë së taksapaguesve. Kurse punësimi i propaguar me të madhe në ndërtim të këtyre rrugëve nuk mund të quhet

<sup>27</sup> UNDP "Raporti i Paralajmërimit të Hershëm i Kosovës". Raporti nr. 20/21 Edicion Special Janar – Qershor 2008 <[http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/EWR20\\_alb\\_press.pdf](http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/EWR20_alb_press.pdf)>

<sup>28</sup> UNDP "Fast Facts", Early Warning Report 23. December 2008  
[http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/Fast\\_Facts\\_23\\_EnglishFINAL.pdf](http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/Fast_Facts_23_EnglishFINAL.pdf)

<sup>29</sup> Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë "Ndikimi i korrupsionit në Komunitetin e Biznesit në Kosovë". Nëntor 2008 <http://www.amchamksv.org/>

kontribut për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik duke qenë se ato janë zgjidhje të përkohshme nuk ofrojnë përmirësim të qëndrueshëm të gjendjes. Një buxhet që së bashku për dy vite përbën rreth 250 milionë euro do të mund të përdorej në mënyrë shumë më të mençur po të mos kishte qenë Qeveria Thaqi e fiksuar mbas krijimit të përshtypjes vizuale se Kosova është duke u zhvilluar por të kishte ide më të mira sesa hedhja e thjesht dhe pa ndonjë studim e buxhetit në asfalt dhe beton. Për shembull një zhvillim ekonomik më i madh dhe më i qëndrueshëm do të ishte arritur sikur një pjesë e këtij fondi të përdorej për subvencionim të bizneseve prodhuese dhe në përkrahjen e tregut financiar.

### **Tenderimi jotransparent**

Tenderimi si procedurë është futur në një rreth të mbyllur mes institucionit që shpall tenderin dhe Agjensionit për prokurim nën një mungesë serioze të transparencës. Organi shqyrtues i Prokurimit (OshP) është i dominuar nga anëtarë të PDK-së, gjë që përbën shkelje të Ligjit për prokurim publik dhe jep mundësi manipulimi të tenderave për qëllime politike.

Në vazhdimësi është përsëritur nga ana e ministrit të transporteve e telekomunikacionit fakti se përkundër një volumi shumë të madh të punëve në shtrimin e rrugëve nuk ka pasur asnjë ankesë nga ana e kompanive. Mungesa e ankesave mund të shpjegohet me faktin se pothuaj se të gjitha kompanitë kanë marrë punë, por shumë aspekte të rëndësishme qeverisjes së sektorit të prokurimit pothuaj se nuk kanë qenë fare subjekt fokusit publik. Shembulli më skandaloz është ideja e nxjerrur nga ana e ministrit Limaj për krijimin e një të ashtuquajturë “Listë të zezë” të kompanive që janë përfshirë në shkelje nga qeverisja e kaluar. Sot e kësaj dite e ashtuquajtura “Listë e zezë” e Limajt ka ngelur një faqe e bardhë në portalin e Komisionit për prokurime publike. Ky fakt nxjerr dy pyetje të rëndësishme:

- meqë nuk është krijuar “lista e zezë” siç ka pretenduar ministri Limaj, ky pretendim se ka pasur shkelje në prokurim në të kaluarën ka qenë i sakt apo jo? dhe
- sa ka ndikuar kërcënimi për futjen në listë të zezë në mungesën e ankesave nga ana e kompanive

Në anën tjetër procese të rëndësishme prokurimi kanë filluar të përgaditen pa ndonjë transparencë dhe publicitet të mjaftueshëm paraprak. Këtu vlen të përmendet një tender për marketing i qeverisë prej rreth 10 milionë eurosh, i cili është kritikuar shumë për shkak të krijimit të kriterëve të njëanshëm të tilla që u pamundëson shumicës së bizneseve vendore që të aplikojnë. Kriteret e zhvilluara për këtë tender ka shumë mundësi që të favorizojnë ndonjë grup interesi të afërta me pushtetin dhe dyshimet e nxjerra nga brenda institucioneve se persona që kanë qëndruar prapa finansimit të fushatës zgjedhore të PDK-së mund të ndikojnë në këtë provocim të vëmendje.

Prokurimi tjetër që nxit dyshime për manipulime të mëdha është ai i një kontrate të lidhur mes Distribucionit të KEK-ut (KOSST) dhe firmës Komtel inxhinjering. Nuk është hera e parë që KOSST nënshkruan kontrata me kompaninë Komtel, por faktet se drejtori aktual i KOSST, Fadil Ismaili, njihet në publik si themelues i Komtelit dhe se në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes në fjalë është parë edhe ish-zv.ministri i energjisë Agron

Dida, nxjerrin dyshime se kjo marrëveshje është arritur me ndikime. Për mendimin tonë edhe këta tendera të KOSST-it me Komtel kërkojnë një hetim serioz nga organet kompetente.

### **Keqinterpretimi i të dhënave nga qeveria**

Në shumë aspekte qeveria nuk e ka kryer detyrimin para qytetarëve për transparencë. Të dhënat që ekzistojnë edhe pse tepër të mangëta nuk kanë qenë të qasshme për publik sidomos në aspektet më të rëndësishme të tyre. Kjo para së gjithash vlen për portalin e regjistrimit të bizneseve, i cili në të shumtën e kohës nuk ka funksionuar, kurse portali i komisionit për prokurime publike është pothuaj se i papërdorshëm qysh prej fillimit. Në anën tjetër, mungesë serioze të të dhënave kredibile shkakton shtyrja e regjistrimit të popullsisë. Kjo po krijon hapësirë për qeverinë të manipulojë me shifra dhe të dhëna, duke i lënë hipotetike të dhënat mbi varfërinë, papunësinë, edukimin, zhvillimin ekonomik, etj. Mungesa e regjistrimit të popullsisë poashtu shkakton një vështirësi në krijimin e idesë së proporcionalitetit të reprezentimit të komuniteteve në Kosovë. Gjithashtu, mungesa e të dhënave për popullsinë shkakton një hendikep edhe në krijimin e njohurisë mbi raportin e pronësisë së komuniteteve në Kosovë dhe të drejtat e tyre në raport me pronën publike.

Mos-serioziteti i qeverisë ndaj kredibilitetit të të dhënave është parë edhe me manipulimin e të dhënave në disa forma si:

- Përdorimi i hulumtimeve jokredibile dhe injorimi i studimeve serioze të opinionit – kjo u pa sidomos me rastin kur qeveria i dha një hapësirë shumë të madhe studimit të dyshimt të Gallup International dhe e injoroi totalisht hulumtimin e UNDP-së në kuadër të Raportit për paralajmërim të hershëm edhe pse ky i fundit njihet si shumë më mirë i hulumtuar.
- Keqinterpretimi i qëllimshëm i të dhënave siç ishte rasti i shifrave të dala nga Raporti i komisionit evropian, sipas të cilit ka rritje të eksportit për 63%, kurse importi është rritur për 27%. Duke marrë para sysh se raporti mes eksportit dhe importit në Kosovë është diku 95% me 5%, atëherë në vlera absolute del se eksporti është rritur shumëfish më shumë në krahasim me rritjen e importit.
- Përdorim i të dhënave të tejkaluara ose për periudha që s'kanë të bëjnë me periudhën e kësaj qeverie siç ishte rasti kur qeveria ka propaguar në mediat e veta se ka një rritje prej 6% edhe pse këto të dhëna të FMN-së kishin të bënin për periudhë që s'kishte të bënte me qeverinë Thaqi<sup>30</sup>.

Nëse shifen të dhënat e Raportit për paralajmërim të hershëm del se të ardhurat e popullsisë në Kosovë jo që janë rritur por kanë shënuar edhe rënje<sup>31</sup>. Në anën tjetër papunësia dhe varfëria në Kosovë ngelin në një nivel pakrahasimisht të madh për rajon dhe Evropë dhe del si problemi më i madh për sigurinë<sup>32</sup>.

### **Rritja ekonomike -**

<sup>30</sup> Gazeta Express, “U rrit 6%”, fq. 10/11

<sup>31</sup> [http://ëëë.kosovo.undp.org/repository/docs/Fast\\_Facts\\_23\\_EnglishFINAL.pdf](http://ëëë.kosovo.undp.org/repository/docs/Fast_Facts_23_EnglishFINAL.pdf)

<sup>32</sup> Po aty.

Qeveria e Kosovës doli me deklarata se gjatë mandatit të saj për vitin 2008 kishte rritje ekonomike për 6 %, shifër kjo e cila shumë shpejt u hudh poshtë nga burime tjera të pavarura si dhe instituti RIINVEST, të cilat e qesin shifrën e përgjysmuar si reale. Papunësia vlerësohet të jetë po aq alarmante sa ishte në vitin 2007<sup>33</sup>. Poashtu varfëria ka ngelur në shifra alarmuese, kurse deficitit tregtar qëndron në masën prej 95%. Në anën tjetër vlerësohet se për shkak të korrupsionit të lartë bizneset në Kosovë e kanë të vështirë madje edhe të operojnë pa përmendur problemet tjera që i hasin. Sipas Odes Ekonomike Amerikane në Kosovë Mbi gjysma e bizneseve, apo 66 % sosh, vlerësojnë se nuk mund të jenë efikas në punën e tyre nëse nuk ofrojnë mito për ndonjë zyrtar institucional sidomos në rastet e tenderëve apo në rastet e prokurimit publik.

Suficitj prej 170 milionë eurove për një vit, në një vend të pazhvilluar ekonomikisht dhe me një gjendje të rendë sociale, jo vetëm që pasqyron moszhvillim ekonomik, por edhe paaftësi në menaxhimin edhe me atë pak buxhet sa ka Qeveria e Kosovës. Mbi 2000 projekte të parashikuara për vitin 2008 ishin ndarë 406 milionë euro, ndërsa deri në fund të muajit tetor janë shpenzuar vetëm 186 milionë euro, për të implementuar diçka më shumë se gjysmën e projekteve<sup>34</sup>. Në anën tjetër qeveria ka deklaruar në mënyrë të pasakt se ka rritur të hyrat vetanake për rreth 15%. Buxheti për vitin 2009 është 1.4 Miliardë euro, por edhe këtij viti llogaritet se bartja e mjeteve nga buxhetet e viteve paraprake si pasojë e suficitit është mbi 200 milionë euro.

### **CEFTA dhe ndalimi i prodhimeve kosovare**

Përveç se ka pasur mungesë idesh për të ndihmuar një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, qeveria nuk ka pasur guximin as ta mbrojë prodhuesin kosovar nga veprimet arbitrare të shteteve fqinje të motivuara nga politika. Që nga data 3 dhjetor, 2007, Serbia dhe Bosnja bllokuan të gjitha mallrat nga Kosova duke shkelur marrëveshjen e CEFTA-s, e cila po respektohet në përpikmëri vetëm nga Kosova. Qeveria e Kosovës përkundër propagandës se do të veprojë me reciprocitet ndaj këtyre shteteve, injoroi faktin se pozicioni politik abstenues që ka marrë në raport me kontrollin e kufirit me Serbinë nuk mundëson një implementim të një përkushtimi të tillë deklarativ<sup>35</sup>. Për të dhënë përshtypjen se është duke u vepruar dicka qeveria vendosi të ndërmernte një hap të paprecedent në historinë e CEFTA-s me letrën që i dërgoi Sekretarit të Marrëveshjes CEFTA e cila natyrisht se nuk përkrah një vendim eventual të qeverisë për të bllokuar mallërat e shteteve fqinje duke qenë se është tërësisht kundër parimit për çka ky institucion është krijuar.

### **Politikat e MEF-it kundërproduktive**

Politikat e ndërmarrja nga MEF-i në menaxhimin e borxheve të bizneseve jo vetëm që ishin të njëanshme dhe të ndikuara politikisht nga një numër i kufizuar i bizneseve, por, ashtu siç u paralajmërua nga kritikët, arriti efekte të kundërta, shtoi borxhet e bizneseve ndaj ATK-së. Gjatë vitit 2008 Qeveria e Kosovës mori vendim për faljen e ndëshkimeve mbi tatimet e të gjitha subjekteve që paguajnë borxhet e tatimeve bazë dhe interesin. Këto

<sup>33</sup> Raporti i Progresit për Kosovën, fq 29, Komisioni Evropian

<sup>34</sup> Express, “Sërisht me suficit”, E enjte, 02.01.2009

<sup>35</sup> Qeveria e Kosovës publikisht ka hequr dorë nga qëllimi për të kontrolluar këtë pjesë të territorit prandaj realisht e ka të pamundur që të veprojë në zbatimin e masave reciproke me Serbinë e Bosnjen

politika diskriminuuese ndaj atyre bizneseve që janë tatim pagues të rregullt nuk sollën efekt për mbledhje të tatimeve nga ATK-ja. Në fund të dhjetorit ATK-ja rezultoi me 189 milionë euro borxhe të painkasuara<sup>36</sup>.

Poashtu, me miratimin e projektligjit për tatimin në të ardhura nga Kuvendi i Kosovës thuhet se Kosova do ketë taksat më të ulëta në rajon, duke bërë uljen prej 10% të takës në të ardhura, por TVSh u rrit me 1%. Kjo politikë favorizon ata që kanë të ardhura të larta dhe rëndon edhe më tej mbi kurrizin e shumicës së qytetarëve që marrin paga të ulëta. Në këtë mënyrë Qeveria nxjerr politika që do të thellojnë varfërin dhe hendekun në të ardhura.

### **Shtrenjtimi i energjisë elektrike**

Në vazhdim të këtyre politikave që vetëm sa thellojnë varfërinë në vend, u morën edhe vendime për shtrenjtimin e energjisë elektrike dhe ujit të pijshëm. Barrën për këto taksa nuk do t'i bartin të gjithë qytetarët njësoj duke qenë se 150 milionë euro të shpenzuara nga serbët as që faturohen. Qeveria akoma nuk ka marrë guxim të trajtojë këto borxhe ndaj KEK-ut edhe pse është e qartë që tashmë ato janë bërë një barrë shkatërruese për këtë kompani. Paguesit e rregullt janë goditur vazhdimisht nga qeveria me shtrenjtim duke u përpjekur të kompenzojë mospagesën jo vetëm në enklavat serbe por edhe nga bizneset që gëzojnë privilegje për shkak të ndikimeve politike.

## **KAOSI DHE KRIMI NË SHËNDETËSI**

### **Krimi i organizuar në shëndetësi**

Shpërfaqja e segmenteve të krimit të organizuar në sistemin shëndetësor të Kosovës përmes arrestimit të pronarëve dhe personelit të disa klinikave private gjatë muajit nëntor, dëshmon se pjesë të politikës kosovare kanë qenë ngushtë të lidhur me këto biznese ilegale për të cilat është ditur me vite se funksionojnë. Me gjithë faktin se Inspektorati i Ministrisë së Shëndetësisë ka pasur njohuri për aktivitetet e këtyre klinikave, vetëm gjatë muajit nëntor u bë një fushatë spektakolare e arrestimeve dhe mbylljeve të klinikave private të cilat funksiononin pa licenca dhe kryenin aktivitete të dyshimta, siç ishte rasti i klinikës “Medicus”, ku kryheshin transplantime të organeve njerëzore. Mirëpo, vetëm disa ditë pas këtyre arrestimeve, Ministria e Shëndetësisë (MSh) i dërgon letër policisë së Kosovës ku kërkon që listën e klinikave private për të cilat kërkonte nga Policia që të mbylleshin, po e tërhiqte duke urdhëruar policinë që “të mos ndërrmerrej asgjë”. Sipas kësaj liste, ishin 40 klinika private të palicencuara që duhej të mbylleshin. Mirëpo, pas “presionit” të bërë në Ministrinë e Shëndetësisë, kjo listë ishte urdhëruar të tërhiqej nga policia.<sup>37</sup>

Duke tentuar të bëjë marketing të luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, kryeministri Thaçi i mbështeti publikisht arrestimet e fundit, mirëpo zv. kryeministri Kuqi tha se “këto arrestime u ngjajnë arrestimeve të banditëve”, dhe kërcënoi MSh-në dhe Policinë e Kosovës se “dikush do të shkoj nga aty”.<sup>38</sup> Këto deklara kundërtënëse të

<sup>36</sup> Koha ditore, 15 janar 2009

<sup>37</sup> Koha Ditore, 29 nëntor 2008

<sup>38</sup> Kuvendi i Kosovës, 4 Dhjetor 2008

dy njerëzve kryesor në qeverinë e Kosovës tregojnë për dy gjëra të rëndësishme: arrestimet po bëhen për të krijuar imazhin e qeverisë se kinse po lufton krimin e organizuar dhe korrupsionin, dhe tendenca për të shtrirë kontrollin në Policinë e Kosovës.

Përmes intervistave të kryera me zyrtarë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe shërbyes civil, Organizata ÇOHU! mëson se në dështimin për furnizim të rregullt me barna të listës esenciale dhe materialeve operative, janë të përfshirë grupe të krimit të organizuar të lidhura me kompani farmaceutike dhe zyrtarë të lartë të politikës vendore të cilët manipulojnë me listën esenciale të barnave për përfitime financiare.<sup>39</sup> Çështja bëhet alarmante kur kësaj i shtohen edhe dyshimet se këtu janë të përfshirë edhe deputetë të Kuvendit të Kosovës, të cilët kanë klinika private të palicencuara<sup>40</sup> dhe të cilët po tregohen imun ndaj sundimit të ligjit në Kosovë. Porositë për furnizim me barna të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës bëhen në atë mënyrë për të evituar procedurat e prokurimit dhe për të justifikuar porosi emergjente të cilat i kryejnë nëpër kompani farmaceutike me të cilat ndajnë përfitimet.<sup>41</sup> Një prej këtyre rasteve ishte edhe ish-drejtori i Departamentit të Farmaceutikës brenda Ministrisë së Shëndetësisë, Nexhdet Kondirolli, i cili në të njëjtën kohë ishte edhe pronar i kompanisë farmaceutike “Kondirolli”, duke vepruar në konflikt të qartë interesi. Në skandalet e Kondirollit me barna ishte përfshirë edhe Këshilltari i Lartë për Shëndetësi i Kryeministrit Thaçi, Shaip Muja, i cili sipas ligjit sanksionohet të përzhohet në punët e stafit civil. Muja së bashku me Kondirollin ishin përfshirë në furnizimin e QKUK-së me barna të paregjistruara dhe pa përfillur procedurat e prokurimit, duke bërë shkelje të ligjit, dhe duke krijuar dyshime të thella për keqpërdorim të parasë publike dhe rrezikim të jetës së pacientëve.<sup>42</sup>

Skandali i radhës i cili përfshiu ushtruesin e suspenduar të detyrës së Sekretarit Permanent të Ministrisë së Shëndetësisë, Ilir Rrecaj, i cili i kishte lëshuar licencë klinikës private “Medicus” për kryerjen e veprimtarive klinike duke përfshirë edhe transplantimin e organeve njerëzore, është edhe një rast ilustrativ i shkallës së lartë të krimit të organizuar të lidhur me politikën brenda sistemit shëndetësor. Ilir Rrecaj, i arrestuar nga policia e Kosovës për përfshirjen në skandalin me klinikën Medicus të cilës Rrecaj i kishte lëshuar licencë për transplantimin e organeve njerëzore, është nga radhët e PDK-së, dhe në bazë të informatave të brendshme, PDK ka ushtruar presion për emërimin e tij në postin e Sekretarit Permanent të MSH-së. Përkundër faktit se që të dy rastet i janë përcjellur organeve të drejtësisë, këto të fundit po tregohen të pafuqishme të zbatojnë ligjshmërinë në Kosovë.

### **Mungesa e përkrahjes politike dhe gjahu medial**

Premtimet e kryeministrit Thaçi se shëndetësia do të jetë prioritet i qeverisë, si dhe vizita e tij e famshme në QKUK ku deklaroi se “shpesh herë pacientët dalin më të semurë sesa që kanë hyrë” ka mbetur vetëm deklaratë në shërbim të marketingut politik të qeverisë

<sup>39</sup> Intervista me zyrtarë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe shërbyes civil

<sup>40</sup> Isuf Ulaj, Drejtor i Qendrës Klinike Universitare – KTV, 07.11.2008.

<sup>41</sup> Intervista me zyrtarë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe shërbyes civil

<sup>42</sup> Koha Ditore, 8 qershor 2008

Thaçi.<sup>43</sup> Përkundrazi, shëndetësia vazhdon të mos konsiderohet prioritet i kësaj qeverie, dhe kjo u dëshmuar edhe njëherë përmes përpilimit të buxhetit të Kosovës për vitin 2009, ku Ministrisë së Shëndetësisë i janë ndarë vetëm 66 milionë euro, kur dihet se vetëm për furnizim të rregullt të të gjithë qytetarëve të Kosovës me barnat e listës esenciale duhen 30 milionë euro. Duke qenë ministri e partisë së dytë të koalicionit qeverisës, LDK-së, Ministria e Shëndetësisë ka vuajtur nga mungesa e përkrahjes politike të cilën e gëzojnë ministratë të cilat i takojnë partisë më të madhe në koalicion, PDK-së.

Tentimet e kryeministrit për të shtrirë duart në punët e Ministrisë së Shëndetësisë përmes delegimit të kandidatëve për Sekretar të Përhershëm të kësaj ministrie kanë vazhduar të shkaktojnë çarje serioze në funksionimin e rregullt të sistemit shëndetësor. Të gjithë kandidatët e përzgjedhur për listën e ngushtë për postin e Sekretarit Permanent të Ministrisë së Shëndetësisë ishin nga radhët e PDK-së<sup>44</sup>, përfshirë edhe ish-ushtresin e detyrës së Sekretarit Permanent, Ilir Rrecaj.

Sipas intervistave që ka zhvilluar Organizata ÇOHU!, zyrtarë të lartë të politikës kosovare janë të përfshirë në krimin e organizuar në sistemin shëndetësor të Kosovës, përmes klinikave private të palicencuara apo kompanive farmaceutike që bëjnë biznes me barna ilegale dhe shumë shpesh edhe me afate të skaduara. Madje, ministri Gashi në fjalimin e tij para Kuvendit të Kosovës tha se “në kriminalitetin në shëndetësi kanë dorë zyrtarë të lartë të udhëheqjes politike të Kosovës”<sup>45</sup>.

MSh, e lënë pasdore dhe pa mbështetje politike dhe financiare, është fajësuar në vazhdimësi për kaosin që mbretëron në sistemin shëndetësor në Kosovë, përkundër faktit se qeveria në vazhdimësi ka sabotuar dhe penguar Ministrinë e Shëndetësisë në përballjen me gjendjen e rëndë të sistemit shëndetësor. Këtij sabotimi dhe gjahu medial i kanë prirë medime të caktuara të kontrolluara nga Qeveria në krye me PDK-në. Në seancën parlamentare kushtuar gjendjes në shëndetësi deputetë të PDK-së kritikuan ministrin Gashi, gjë të cilën nuk i shohim ta bëjnë në lidhje me ministratë e udhëhequra nga anëtarë të PDK-së.

### **Çmimorja dhe sigurimet shëndetësore**

Përkundër përpjekjes së Ministrisë së Shëndetësisë për të përmirësuar situatën e mjerë të sistemit shëndetësor, ajo ka vazhduar të punojë pa një strategji vepruese e cila do të vinte këtë sektor në binarë të përmirësimit konstant. Pikërisht përmes futjes së çmimeve për shërbime shëndetësore në shëndetësinë publike e cila ka çmime marramendëse, MSh tenton të gjej zgjidhje të shpejta, të cilat fatkeqësisht gjithmonë shkojnë në dëm të pjesës së varfër dhe të papunë të popullatës së Kosovës. Në kohën kur varfëria dhe papunësia vazhdon të rritet në Kosovë, një sistem i shëndetësisë përmes sigurimeve shëndetësore

---

<sup>43</sup> Këto deklarata të kryeministrit të përkujtojnë deklaratat e tij në fillim të mandatit ku i kishte shpallur kampione të korrupsionit kompanitë publike (KEK, PTK, ANP) vetëm për të vazhduar me luftë politike duke vendosur njerëzit e tij në postet udhëheqëse të këtyre kompanive. Shih raportin e Organizatës ÇOHU! mbi 100 ditët e para të Qeverisë Thaçi “Luftimi i korrupsionit me retorikë”.

[http://www.cohu.org/raporte/Raporti\\_100Diteshi\\_Qeverise\\_Thaci.doc](http://www.cohu.org/raporte/Raporti_100Diteshi_Qeverise_Thaci.doc)

<sup>44</sup> Gazeta Express, 17 gusht 2008

<sup>45</sup> Alush Gashi, Kuvendi i Republikës së Kosovës – 28 tetor 2008

është pikërisht i dizajnuar të funksionojë dhe të jetë në shërbim vetëm të pjesës së pasur të popullatës.

## **ARSIMI I LARTË**

### **Gjendja e përgjithshme**

Njëra prej sferave shoqërore e cila aspak nuk ka shënuar përmirësime për sa i përket cilësisë së ofruar është arsimit i lartë. Problemi fundamental që e ka përcjellë këtë fushë ka qenë ndërhyrja direkte politike që i është bërë këtij sektori nga partitë politike me qëllim të shtrirjes së pushtetit sa më të madh në të. Përveç kësaj, edhe abuzimet e tjera individuale dhe klanore me karakter përfitimi ekonomik po ashtu e kanë stopuar zhvillimin e këtij sektori.

Partitë politike qysh prej përfundimit të luftës përmes instalimit të klaneve në strukturat udhëheqëse dhe vendim-marrëse të Universitetit të Prishtinës (UP) substancialisht kanë minuar progresin në këtë institucion. Politizimi i të gjitha strukturave të brendshme të UP-së dhe përdorimi i tyre për interesa të ngushta klanore si dhe rivaliteti i vazhdueshëm me Ministrinë e Arsimit ka bërë që UP-ja të mos funksionojë si një institucion i qëndrueshëm edukativo-arsimor. Edhe sot e kësaj dite UP-ja ende ballafaqohet me ndërhyrje direkte politike si dhe me keqpërdorime, duke bërë që ky sektor shumë i rëndësishëm për zhvillimin e gjithëmbarshtëm shoqëror të mos shënojë aspak përparim. Edhe vendimi i qeverisë për mos-akreditim dhe mos-licencim të institucioneve private të arsimit, edhe pse në shikim të parë mund të duket i qëlluar, do të gjenerojë pasoja në përfundim të të ashtuquajturës fazë e dyte e tij. Kjo pasi që vendimi ka qenë jologjor dhe është marrë mbi bazën e një procesi që nuk i ka plotësuar kushtet që të quhet akreditim.

### **UP-ja arenë Gladiatorësh**

Vendimet e fundit unilaterale të marra nga ana e MASHT-it dhe Qeverisë, pa një konsultim paraprak dhe konstruktiv me organet drejtuese të UP-në, rrezikojnë që edhe më tutje ky institucion të vuaj nga ndërhyrjet politike dhe kështu, të mos mund të krijojë një bazë të qëndrueshme të funksionimit të tij. Ftesa që iu bë Rektorit dhe Dekanëve të UP-së nga ana e kryeministrit dhe ministrit të arsimit rreth decentralizimit dhe autonomisë financiare të këtij institucioni paraqet rastin më të fundit të orvatjes së kontrollit direkt politik mbi të. Me këtë rast, Qeveria dhe Ministria e Arsimit edhe një herë kanë treguar që problemet me të cilat ballafaqohet ky institucion nuk do të zgjidhen përmes rrugëve ligjore por përmes formave të presionit direkt nga ana e pushtetit aktual.

Ministri i Arsimit, Enver Hoxhaj, dhe Rektori i UP-së, Enver Hasani, në korrik të këtij viti kanë nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi<sup>46</sup> me qëllim që UP-së “t’i sigurohet e drejta e pavarësisë financiare në mjetet buxhetore për menaxhimin më efikas të tyre”. Ndërsa, një ditë pas ‘bisedës informative’ tek kryeministri në të cilin rektori dhe shumica e dekanëve nuk u paraqitën, Ministria e Arsimit mori vendim për pezullim të tij duke u

---

<sup>46</sup> <http://www.masht-gov.net/advCms/#id=20,138,82,7,2008>



quajtur atë vetëm ‘një draft që duhet të finalizohet’<sup>47</sup> edhe pse në të qartazi precizohet se implementimi i tij fillon nga data 01 tetor, 2008.

Megjithëkëtë, autonomia financiare e UP-së nuk mund të rregullohet vetëm me një Memorandum të Mirëkuptimit apo vendim të Qeverisë, por domosdoshmërisht kërkon amandamentimin e Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike. Për më shumë, memorandum i nuk e precizon se si do të rregullohet UP-ja, si agjenci shpenzuese apo si ndërmarrje publike, ndërsa kjo ndarje sipas ekspertëve të arsimit konsiderohet shumë e domosdoshme<sup>48</sup>. Veç kësaj, vendimi që UP-së t’i hiqet e drejta për investime kapitale dhe kjo të mbetet prerogativë e MASHT-it, substancialisht e demanton proklamimin e Qeverisë dhe MASHT-it për dhënie të autonomisë financiare UP-së. Nuk mund të pretendohet që UP-ja është institucion i pavarur financiarisht pa të drejtën e investimeve kapitale. Në këtë kontekst, Qeveria me vendim unilateral pa u konsultuar me drejtuesit e UP-së, ka vendosur që këtij institucioni t’ia marr 1 milion euro të buxhetit të saj për vitin 2008, të dedikuara për investime kapitale, po ashtu e kundërshton pretendimin e Qeverisë dhe të MASHT-it se UP-ja tashmë është institucion i pavarur financiar. E vetmja gjë që është vendosur në tërë këtë nismë të Qeverisë dhe MASHT-it, ka të bëjë vetëm me disa lehtësime të procedurave administrative e që praktikisht nuk është dhënien e autonomisë financiare UP-së. Shihet qartazi se nënshkrimi i marrëveshjes në mes MASHT-it dhe UP-së, rreth autonomisë financiare ka të bëjë me marketing politik me qëllim përfitimi elektoral se sa me një iniciativë serioze e ndërmarrë nga ministri i arsimit dhe Qeveria e Kosovës për pavarësimin financiar të UP-së.

Aspekt tjetër që i ka ashpërsuar marrëdhëniet e këtyre dy institucioneve ka qenë decentralizimi UP. Mënyra se si MASHT-i dhe Qeveria i kanë hyrë kësaj nisme ka bërë që Asociacioni i Universiteteve Evropiane të reagoi dhe ta quaj këtë iniciativë “përçaj e sundo” – “divide et impera”<sup>49</sup>. Çështja e decentralizimit dhe autonomisë financiare të UP-së assesi nuk mund të bëhet përmes akteve unilaterale dhe strategjisë së “shkopit dhe karotës”, ku kryeministri deklaroi ‘finalizim të reformave’ dhe ua tërheq vërejtjen ‘strukturave neglizhuara’ dhe ‘mentalitetit të së kaluarës’ se nuk do të mund t’i pengojnë vendimet e qeverisë<sup>50</sup>. Decentralizimi dhe autonomia financiare e UP-së, do të duheshin t’i shtroheshin një diskutimi publik të gjerë ku si synim kanë përzgjedhjen e modeleve të cilat funksionojnë brenda rrethanave tona me qëllim përfundimtar rritjen e cilësisë edukativo-arsimore dhe efektivitetin dhe efikasitetin menaxherialo-financiar të UP-së si tërësi dhe të njësive të saja individuale.

Deklarimi i kryeministrit Thaçi për dyfishim të pagave të mësimdhënësve të UP-së<sup>51</sup>, ka dal jo i vërtetë pasi që në buxhetin për vitin 2009 për UP-në është paraparë një rritje prej vetëm 300.000 mijë euro. Mirëpo, me këtë shumë nuk krijohet hapësirë për rritje të pagave pasi që për këtë vit akademik gati është dyfishuar numri i studentëve të pranuar

<sup>47</sup> Koha ditore “Qeveria shkel Memorandumin me UP-në”, 03.10.2008.

<sup>48</sup> Koha Ditore “Qeveria po punon për ta decentralizuar UP-në”, 04.10.2008.

<sup>49</sup> Koha Ditore “EUA: Qeveria me politikë “përçaj e sundo” ndaj UP-së. 21.10.2008.

<sup>50</sup> Shumica e gazetave ditore, 03.10.2008.

<sup>51</sup> Koha Ditore “Qeveria premton dyfishimin e pagave të mësimdhënësve të UP-së”, 12.10.2008.

në UP dhe si rezultat ka ardhur deri te rritja e stafit akademik. Kështu me këtë rritje të buxhetit është e pamundur rritja e pagave mësimdhënësve të UP-së<sup>52</sup>.

Vendimi po ashtu unilateral i MASHT-it për rritjen e numrit të studentëve ka bërë që UP-ja në këtë vit akademik të ballafaqohet me vështirësi të mëdha. Ky vendim pa analizë paraprake rreth kapaciteteve akademike, teknike dhe hapësinore të UP-së për absorbim dhe në kundërshtim të qartë nga organet e UP-së<sup>53</sup>, qartazi po bëhet me qëllim përfitimi elektoral, e jo siç zyrtarisht është thënë për përfshirjen e sa më shumë studentëve në arsimin e lartë.

### **Deja vu-ja e Akreditimit**

Akreditimi i Institucioneve Private të Arsimit të Lartë (IPAL) tashmë zyrtarisht veç ka hyrë në të ashtuquajturën “faza e dytë” e tij. Gabimi shumë i madh dhe shkelje e qartë ligjore është bërë nga ana e MASHT-it dhe Qeverisë kur procesin e udhëhequr nga Këshilli Britanik për Akreditim (KBA) e kanë quajtur akreditim dhe mbi bazën e tij kanë marrë vendim për mos-akreditim të asnjë prej IPAL-ve, përveç Universitetit Amerikan në Kosovë. Këtij procesi nuk i është nënshtruar Universiteti Publik i Prishtinës.

ÇOHU! në një analizë<sup>54</sup> të saj në korrik të këtij viti ka tërhequr vërejtjen se procesi i udhëhequr nga KBA-ja assesi nuk ka qenë akreditim por një inspektim i gjendjes që mbretëron në këto institucione dhe se ai proces është përcjell me shkelje ligjore dhe mungesë kriteresh dhe procedura transparente dhe të qarta. Për më shumë, ÇOHU! ka argumentuar se ndërhyrja e ministrit të arsimit në këtë proces ka paraqitur cenim të pavarësisë të institucionit (Agjencia e Akreditimit e Kosovës – AAK) që me ligj është e thirrur ta bëjë akreditimin e IPAL-ve.

Pasojat e insistimi të ministrit të arsimit dhe të Qeverisë për ta quajtur akreditim procesin e udhëhequr nga KBA-ja do të shihen në fund të të ashtuquajturës faza e dytë e akreditimit. Sipas Ligjit mbi Arsimin e Lartë në Kosovë, një institucioni i merret licenca për të vepruar në këtë fushë po që se ai dështon të merr akreditimin pas fazës së dytë të tij.<sup>55</sup> Në këtë kontekst, MASHT-i do të detyrohet që në fund të ‘fazës së dytë’ të akreditimit t’ua merr licencat atyre institucioneve që dështojnë të akreditohen. Mirëpo, duhet të kihet parasysh që IPAL-të kanë tepër shumë argumente që vërtetojnë se procesi i udhëhequr nga KBA-ja nuk ka qenë akreditim dhe rrjedhimisht MASHT-i nuk mund t’ua merr licencat. Kështu, IPAL-të mund ta padisin MASHT-in po që se ky institucion ua merr licencat. Mjafton vetëm të krahasohen procedurat dhe koha<sup>56</sup> që do të ndiqen nga AAK-ja gjatë kësaj faze dhe të shihet se projekti i KBA-së nuk ka qenë akreditim, por inspektim i gjendjes që mbretëron në këto institucione. Për më shumë, edhe vet ministri i arsimit në një debat<sup>57</sup> të organizuar nga partia Aleanca Kosova e Re, ka pranuar se procesi i vërtetë i akreditimit fillon me fazën e vet-vlerësimit nga ana e IPAL-të, gjë që nuk ka ndodhur gjatë procesit të udhëhequr nga KBA. Përkundër kësaj, ministri i arsimit si dhe u.d. e AAK-së, në vazhdimësi pas vendimit të Qeverisë për mos-akreditim dhe

<sup>52</sup> Intervistë me zv.rektorin e UP-së Marjan Demaj.

<sup>53</sup> Koha Ditore “UP-ja, nuk planifikon rritjen e numrit të brucoshëve”, 28.09.2008.

<sup>54</sup> [http://www.cohu.org/raporte/AkreditimiUniversitetetPrivate\\_shkeljet.pdf](http://www.cohu.org/raporte/AkreditimiUniversitetetPrivate_shkeljet.pdf).

<sup>55</sup> Neni 11.7 I Ligjit mbi Arsimin e Lartë në Kosovë - 2002/03.

<sup>56</sup> [http://www.akreditimi.org/?Procedura\\_p%EBR\\_akreditim:Procedura\\_ne\\_kat%EBR\\_hapa](http://www.akreditimi.org/?Procedura_p%EBR_akreditim:Procedura_ne_kat%EBR_hapa).  
[http://www.akreditimi.org/?Procedura\\_p%EBR\\_akreditim:Aplikimi\\_dhe\\_procedura](http://www.akreditimi.org/?Procedura_p%EBR_akreditim:Aplikimi_dhe_procedura).

<sup>57</sup> Debati “Gjendja e Arsimit të Lartë në Kosovë” i mbajtur nga AKR-ja më 18.10.2008.

mos-licencim të IPAL-ve, kanë kërcënuar këto institucione se nuk po i përmbushin obligimet që dalin nga Ligji në fuqi dhe raporti i KBA-së<sup>58</sup>.

Në anën tjetër, një pjesë e përgjegjesisë për këtë rrëmujë bie edhe mbi IPAL-të. Këto institucione gjatë gjithë kohës prej se MASHT-i ka publikuar raportin e KBA-së, janë sjellë si strucë oportunist duke mos e kontestuar procesin e akreditimit në tërësi të udhëhequr nga KBA-ja, por duke u fokusuar vetëm në lejimin e regjistrimit të studentëve në vitin akademik 2008/09. Me këtë sjellje, këto institucione kanë dëshmuar se nuk janë të interesuara në ngritjen dhe mbajtjen e cilësisë mirëpo, vetëm në aspektin financiar, në vjeljen materiale të studentëve.

Veç kësaj, ministri i arsimit edhe kësaj here synon që të bëjë shkelje të Ligjit mbi Arsimin e Lartë. Ky ligj, e precizon shumë qartë që akreditimi është kompetencë e AAK-së<sup>59</sup>, ndërsa licencimi i MASHT-it<sup>60</sup>. Mirëpo, në procedurat e përshkruara nga AAK-ja, është vendosur që vendimi për akreditim i marr nga AAK-ja, miratohet nga ministri i arsimit<sup>61</sup>. Është shumë e qartë se krijimi i politikave në këtë fushë është kompetencë e MASHT-it, në bashkëpunim me AAK-në. Mirëpo, ky bashkëpunim mbaron atëherë kur paraprakisht vendosen kriteret dhe procedura të qarta dhe transparente rreth akreditimit dhe puna për vlerësim të cilësisë së institucionit dhe programeve akademike si dhe të marrjes së vendimit është ekskluzivisht kompetencë e AAK-së, gjegjësisht e Këshillit Kombëtar të Cilësisë, dhe jo e ministrit të arsimit apo MASHT-it.

Për më shumë, edhe kësaj here nuk ka kriteret konkrete për sa i përket akreditimit. Kriteret e vendosura nga AAK-ja, për institucione<sup>62</sup> dhe programe akademike<sup>63</sup> janë shumë të përgjithësuara dhe kështu lënë hapësirë për interpretime shumë të gjera nga ana e AAK-së. Ky agjencion ka bërë edhe një gabim kur në përpilimin e kriterëve (listës kontrolluese për institucione dhe programe akademike) tërësisht ka kopjuar kërkesat e kërkuara nga Këshilli Austriak i Akreditimit për institucionet dhe programet akademike<sup>64</sup>. Kjo në shikim të parë mund të duket si një nismë shumë e qëlluar sepse po përdoren kërkesa që aplikohen në Austri, por duhet të kihet parasysh që nevojat e Kosovës dhe të tregut të saj ndryshojnë nga ato të Austrisë. Si pasojë, kriteret e akreditimit të IPAL, duhet me doemos t'u përgjigjen kërkesave vendore në mënyrë që resurset e krijuara të mund të shërbejnë si bazë e mirë për zhvillimin e gjithëmbarshtëm shoqëror.

Edhe kësaj here, me insistim të ministrit të arsimit, është vendosur që në përbërjen e ekspertëve që do ta kontrollojnë cilësinë e institucioneve dhe programeve akademike të IPAL-ve, të ketë vetëm ekspertë të jashtëm. Ky vendim nuk ndihmon aspak në ngritjen e kapaciteteve vendore kur dihet se akreditimi nuk jepet përgjithmonë por ai zgjatë 5 vite<sup>65</sup>, dhe kështu në të ardhmen do të duhen resurse vendore që do të jenë të afta ta bëjnë vlerësimin e cilësisë të institucioneve dhe të programeve akademike. Në këto grupe, do të duhej që së paku njëri prej personave të jetë vendorë.

<sup>58</sup> Gazetat ditore të pas datës së publikimit të Raportit të KBA.

<sup>59</sup> Kapitulli III, neni 11 deri 11.10. i LAL.

<sup>60</sup> Neni 4.1 (k). i LAL.

<sup>61</sup> [http://www.akreditimi.org/?Procedura\\_p%EB\\_r\\_akreditim:Aplikimi\\_dhe\\_procedura](http://www.akreditimi.org/?Procedura_p%EB_r_akreditim:Aplikimi_dhe_procedura).

<sup>62</sup> [http://www.akreditimi.org/?Lista\\_Kontrolluese:List%EB\\_kontrolluese\\_p%EB\\_r\\_institucionet](http://www.akreditimi.org/?Lista_Kontrolluese:List%EB_kontrolluese_p%EB_r_institucionet).

<sup>63</sup> [http://www.akreditimi.org/?Lista\\_Kontrolluese:List%EB\\_kontrolluese\\_p%EB\\_r\\_programet](http://www.akreditimi.org/?Lista_Kontrolluese:List%EB_kontrolluese_p%EB_r_programet).

<sup>64</sup> [http://www.akkreditierungsrat.at/cont/en/acc\\_checklist.aspx](http://www.akkreditierungsrat.at/cont/en/acc_checklist.aspx).

<sup>65</sup> Neni 11.3 i L.A.L.

Ky vendim në fakt është në kundërshtim me arsyetimin që ministri i arsimit e ka dhënë kur është munduar të justifikoj vendimin e tij për cenim të pavarësisë së AAK-së, duke u arsyetuar se në fazën e parë AAK-ja nuk ka qenë e funksionale dhe kështu MASHT-i i ka përdorur kompetencat e veta për ta drejtuar procesin e parë të akreditimit.<sup>66</sup>

Në ‘fazën e dytë’ të akreditimit, MASHT-i ka vendosur që procesin ta udhëheq AAK-ja, gjë që është në përputhje të plotë me LAL 2002/03. Mirëpo, duhet të sqarohet se a mundet që IPAL-të njëherë të akreditohen nga KBA-ja, ndërsa në fazën e dytë nga AAK-ja? Si e rregullon ligji këtë punë? Këto pyetje as ministri i arsimit e as drejtuesit e AAK-së ende nuk i kanë sqaruar.

---

<sup>66</sup> Edhe në atë kohë ky arsyetim nuk ka qenë korrekt sepse AAK-ja ka qenë e themeluar me UA - 2004/14, ka pas organet e saj (Këshilli Kombëtarë i Cilësisë organ që vendosë rreth akreditimit të IPAL) i cili ka punuar në përpilimin e kriterëve dhe të proceduarve të akreditimit si dhe kanë qenë të parapara grupet e ekspertëve për vlerësimin e cilësisë të IPAL-të, e që në asnjë moment nuk janë marrë parasysh nga ministri i arsimit dhe MASHT-i.